



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo



Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency

Raport Vjetor

Janar – Dhjetor 2013

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave.....	1
1. PJESA E PËRGJITHSHME	2
2. RRETH AKK-SË	3
3. ORGANIZIMI I BRENDSHËM	4
4. LUFTIMI I KORRUPSIONIT.....	5
4.1 Zbatimi i ligjit.....	5
4.1.1 Zhvillimi i hetimeve	5
4.1.2 Rastet e përcjella në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm	6
4.1.3 Bashkëpunimi me institucionet tjera që kanë për mision luftën kundër korrupsionit.....	16
4.2 Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017 ..	16
4.3 Avancimi i kuadrit ligjor dhe vetëdijesimi i Publikut.....	18
5. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT.....	19
5.1 Mbikëqyrja dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave	19
5.1.1 Llojet e deklarimit të pasurisë.....	19
5.2 Parandalimi i konfliktit të interesit	25
5.3 Parandalimi i Korrupsionit në aktivitetet e Prokurimit Publik	28
6. Mbështetja profesionale dhe Marrëdhëniet me Publikun	30
6.1 Mbështetja profesionale, Bashkëpunimi dhe Informimi	30
6.2 Resurset njerëzore	32
7. Administrata dhe financat	33
7.1 Planifikimi dhe hartimi i buxhetit.....	33
8. BASHKËPUNIMI DHE AKTIVITETET TJERA.....	35
9. MËSIMET DHE REKOMANDIMET	36
10. Përfundimi.....	37
Shtojca A. Organogrami i Agjencisë	35
Shtojca B. Tabelat	35
Shtojca B1. Pasqyron raportimin në lidhje me zbatimin e veprimeve kundër korrupsionit nga pikat e kontaktit për periudhën qershor – dhjetor 2013.....	35
Shtojca B2. Lista e zyrtarëve të lartë publik që nuk e kanë deklaruar pasurinë	40
Shtojca B3. Lista me katalogët dhe regjistrin e dhuratave sipas institucioneve që mbajnë dhe kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK	41
Shtojca B4. Lista e trajnimeve 2013.....	42

Lista e tabelave

Tabela 1. Rastet e përcjella nëpër organet kompetente që nga funksionalizimi i AKK-së.....	14
Tabela 2. Pasqyron pikat e kontaktit që kanë raportuar dhe nuk kanë raportuar në lidhje me zbatimin e objektivave që dalin nga Plani i Veprimit për periudhën qershor – dhjetor 2013.....	18
Tabela 3. Rezultati i Deklarimit të rregullt vjetor.....	20
Tabela 4. Rezultati i deklarimit me marrjen e detyrës.....	21
Tabela 5. Rezultati i Deklarimit sipas kërkesës së AKK-së.....	21
Tabela 6. Rezultati i Deklarimit të pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik.	21
Tabela 7. Deklarimi i plotë dhe krahasimi i nëpër vite.	23
Tabela 8. Sanksionimi i mos deklarimit të pasurisë ndër vite (2010, 2011, 2012).	24
Tabela 9. Pasqyra e gjithë procesit të rasteve të trajtuara për konflikt të interesit;	26
Tabela 10. Rastet e trajtuara për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik.....	28
Tabela 11. Aktivitetet e ndërprera te prokurimit mbi bazën e opinionëve të AKK-së.....	29

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Pasqyrimi i procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2013	6
Grafiku 2. Pasqyrimi i Kallëzimeve Penale dhe numrit të personave	7
Grafiku 3. Përcjellja e rasteve sipas strukturës së veprës penale	8
Grafiku 4. Numri i rasteve të përcjella në organet kompetente si ... 2007- 2013	14
Grafiku 5. Realizimi i masave të Planit të veprimit kundër korrupsionit nga insitucionet e Kosovës ..	17
Grafiku 6. Rezultati i procesit të tërësishëm të deklarimit të pasurisë për gjatë periudhës	22
Grafiku 7. Procesi i përgjithshëm i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga	24
Grafiku 8. Numri i zyrtarëve që ushtrojnë më shumë se një funksion	27
Grafiku 9. Shkrimet për Korrupsion në shtypin ditor sipas muajve gjatë vitit 2013.....	31
Grafiku 10. Numri i shkrimeve të gjitha mediave të shkruara për punën e Agjencisë	32
Grafiku 11. Shpërndarja buxhetore nëpër kategori të caktuara ekonomike.....	34
Grafiku 12. Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike	34
Grafiku 13. Krahasimi i buxhetit të përgjithshëm dhe realizimi i tij për vitet 2011-2013.....	35

Lista e shkurtesave

PSH	<i>Prokuroria e Shtetit</i>
PSRK	<i>Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës</i>
PPQ	<i>Prokuroria Publike e Qarkut</i>
PPK	<i>Prokuroria Publike Komunale</i>
PTH	<i>Prokuroria Themelore</i>
IP	<i>Inspektorati Policor</i>
FIU	<i>Financial Investigation Unit</i>
UP	<i>Universiteti i Prishtinës</i>
GJK	<i>Gjykata Kushtetuese</i>
MASHT	<i>Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë</i>
MEF	<i>Ministria e Ekonomisë dhe Financave</i>
KQZ	<i>Komisioni Qendror Zgjedhor</i>
KRPP	<i>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik</i>
KEK	<i>Korporata Energjetike e Kosovës</i>
KDI	<i>Kosovo Democratic Institute</i>
QKSPEZH	<i>Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim</i>
FLSA	<i>Financial Law Smart Agency</i>
IKAP	<i>Instituti Kosovar për Administratë Publike</i>
LDC	<i>Leadership and Development Consultancy</i>
RESPA	<i>Regional School for Public Administration</i>
BRC	<i>Bratislava Region Center</i>
UNDP	<i>United Nation Development Program</i>
ASHAK	<i>Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës</i>
SACIK	<i>Support Anty-Corruption Institution's of Kosovo</i>
EU	<i>European Union</i>
MDA	<i>Management Development Asociacion</i>
SPV	<i>Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencia kundër Korrupsionit 3</i>

1. PJESA E PËRGJITHSHME

Përkundër një angazhimi të përgjithshëm institucional veprat penale të korrupsionit vazhdojnë të përbëjnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes por njëkohësisht përbëjnë edhe veprat penale për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime. Kjo për shkak të kompleksitetit të veprës penale, mënyrës së kryerjes si dhe kryerësve të këtyre veprave penale.

Agjencia kundër Korrupsionit tash e sa vite është duke punuar me përkushtimin drejtë krijimit të një ambienti shoqëror të lirë nga ndikimi i korrupsionit. Në këtë rrafsh janë përcaktuar prioritete të çarta për zbatimin të legjislacionit, parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional

Bazuar në të dhënat e këtij raporti vërehet se nevojiten përpjekje të përbashkëta të kompletë sistemit të drejtësisë si dhe mekanizmave të tjerë që kanë për mision luftën kundër korrupsionit në mënyrë që të ndërtohet një infrastrukturë e fuqishme institucionale që prodhon rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe përfundimisht të krijohet fryma e besimit qytetar.

AKK që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit, nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka përcjell në prokuroritë kompetente, prokurorinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Njësinë e Hetimeve Financiare, gjithsejtë **420** raste. Në vitin 2007 AKK në Institucionet Kompetente ka përcjellë 47 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 91 persona, në vitin 2008 ka përcjellë gjithsejtë 53 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 113 persona, në vitin 2009 AKK ka përcjellë 68 raste ku janë të përfshirë 159 persona, në vitin 2010 ka përcjellë 33 raste, ndërsa janë të përfshirë 164 persona, në vitin 2011 ka përcjellë 39 raste të përfshirë 121 persona, në vitin 2012 janë përcjellë gjithsejtë 52 raste me përfshirje të 159 personave. Ndërsa, në vitin 2013 janë përcjellë gjithsejtë 128 raste kundër 238 personave.

Siç shihet gjatë vitit 2013 ka një rritje të madhe të kallëzimeve penale të cilat Agjencia i ka adresuar nëpër prokurorit kompetente. Kjo është si rrjedhojë që në Kodin Penal të Kosovës (i hyrë në fuqi në fillim të vitit 2013) mos deklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rremë i saj paraqesin vepër penale.

Një karakteristik që është vërejtur gjatë periudhës raportuese është hedhja poshtë e rasteve të Agjencisë nga ana e Prokurorive. Në shumicën e rasteve kur Prokuroritë kanë hedhur poshtë apo kur kanë pushuar hetimet, sipas arsytimit mund të vlerësohet se njohuritë e Prokurorëve rreth Ligjit të Prokurimit janë bazike dhe shkeljet e tij nuk trajtohen drejtë, ngase dëmi i shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve ende mbetet i pa sanksionuar.

Ky raport vjetor që mbulon periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2013, i cili i adresohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, është i shtati me radhë. I ndarë në disa kapituj raporti pasqyron në detaje të gjitha aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra nga Agjencia për këtë periudhë kohore.

2. RRETH AKK-SË

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa ka filluar të funksionojë më 12 shkurt të viti 2007. Baza ligjore për themelimin e Agjencisë është Ligji kundër Korrupsionit (2004/34) i cili i ka përcaktuar përgjegjësitë dhe fushë-veprimtarinë e saj.

Mandati i Agjencisë është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë që bazohet në shtetin e së drejtës.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Bazuar në kuadrin ligjor AKK për punën e vetë duhet ti raportoj në baza vjetore Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ndërsa ky është raporti i shtatë që Agjencia i paraqet Kuvendit, dhe në mënyrë të detajuar i pasqyron aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra gjatë vitit 2013.

Këto aktivitete kanë qenë të përqendruara në:

- Zbatimin e ligjit, ku përfshihen përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente, përcjellja e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore për shkeljet e dyshuara administrative, monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit;
- Parandalimin ose eliminimin e shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes së deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, publikimi i regjistrave të formularëve të deklaramit të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik në faqen zyrtare të AKK-së në internet, parandalimi i konfliktit të interesit dhe regjistrimi i dhuratave të pranuar nga personat zyrtar, si dhe parandalimi i korrupsionit në aktivitetet e Prokurimit Publik;
- Edukimi i zyrtarëve publik dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual të cilët merren me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit si dhe vetëdijesimi i publikut për luftën kundër korrupsionit në sensin e nxitjes së një bashkëpunimi të fuqishëm mes tij dhe AKK-së.

3. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Organizimi i brendshëm i AKK-së është i rregulluar me anë të Rregullores së Punës së AKK-së dhe Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKK. Ato përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat në lidhje me kryerjen e punëve si dhe përgjegjësitë e çdo zyrtari brenda AKK-së.

AKK përbëhet nga Zyra e Drejtorit, Departamentet, Divizionet dhe Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim ([Shtojca A](#)).

Aktualisht në Agjenci punojnë 40 zyrtar dhe atë:

- Zyra e Drejtorit të AKK-së, 5 zyrtar;
- Departamenti për Luftimin e Korrupsionit, 11 zyrtar;
- Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit, 15 zyrtar,
- Divizioni për Punë të Përgjithshme dhe Financa, 5 zyrtar, si dhe
- Zyra për Mbështetje, Bashkëpunim dhe Informim 4 zyrtarë.

Gjatë vitit 2013 në kuadër të Agjencisë janë krijuar dhe funksionalizuar:

1.Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik në kuadër të Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit

2.Zyra e Posaçme e Arkivit, për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit që krijohet gjatë punës së Agjencisë.

Funksionalizimi i Komisioneve:

Gjatë vitit 2013, janë funksionalizuar dy komisione të cilat duhet t'i ketë secili institucion në bazë të legjislacionit në fuqi për Shërbimin Civil, pra:

1. Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve si dhe;
2. Komisioni Disiplinor.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar dhe ka vendosur gjithsej 9 raste kurse Komisioni Disiplinor nuk ka pasur asnjë rast të iniciuar për shqyrtim.

Kapitujt në vijim paraqesin një pasqyrë të plotë të aktiviteteve të kryera nga Agjencia gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 janar – 31 dhjetor 2013.

4. LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e luftimit të korrupsionit në Agjenci, zhvillohen nga Departamenti për Luftimin e Korrupsionit. Në pajtim me mandatin e dhënë me Ligjin nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe me legjislacionin tjetër sekondar, puna e Departamentit për Luftimin e Korrupsionit aktivitetet i zhvillon në këto drejtime; zbatimi i ligjit, monitorimi i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, avancimi i kuadrit ligjor dhe vetëdijesimi i publikut.

4.1 Zbatimi i ligjit

Agjencia kundër Korrupsionit, gjegjësisht Departamenti i Hetimeve në aspektin e zbatimit të ligjit, është përgjegjës për këto aktivitete:

- Zhvillimin e hetimeve paraprake lidhur me akuzat e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk inicohet procedurë penale nga ndonjë mekanizëm tjetër;
- Përcjelljen e rasteve të hetuara tek prokuroria publike kompetente për procedim penal të mëtutjeshëm, si dhe përcjelljen e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore në lidhje me rastet e dyshuara për shkelje administrative;
- Bashkëpunimin me të gjitha autoritet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete.

4.1.1 Zhvillimi i hetimeve

Prioritet i Departamentit për Luftimin e Korrupsionit gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë pranimi, inicimi sipas detyrës zyrtare dhe hetimi paraprak i rasteve të dyshuara të korrupsionit. Si rrjedhojë janë hetuar raste të raportuara nga qytetaret, po ashtu edhe raste të cilat janë iniciuar sipas detyrës zyrtare kur AKK ka ardhur deri te informacionet e bazuara për veprime korruptive të mundshme, si dhe në disa raste është autorizuar nga ana e prokurorisë së EULEX-it për të ndërmarrë veprime hetimore në kudër të mandatit.

Sa i përket rasteve të hetuara me dyshimin për veprime korruptive, si dhe lidhur me vendimet finale gjatë kësaj periudhe raportuese, në vijim do të japim pasqyrën e përgjithshme.

• Rastet e raportuara në AKK për vitin 2013

AKK gjatë vitit raportues nga qytetarët ka pranuar shumë informacione në lidhje me dyshimet për veprime korruptive përmes mënyrave të ndryshme të raportimit. AKK për qytetarët të cilët duan ti raportojnë rastet e dyshuara për korrupsion pati dhënë mundësinë e disa mënyrave të raportimit. Fjala është për raportim të drejtpërdrejtë në AKK, përmes linjës telefonike pa pagesë **0800 10 800**, postës dhe përmes e-mailit (formës online) nga www.akk-ks.org

Gjatë vitit 2013, AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në gjithsej 319 raste, prej të cilave 72 prej tyre janë bartur nga vitet paraprake, kurse gjatë vitit 2013 janë pranuar edhe 247 raste. Prej tyre 128 raste, janë përcjell në Prokurori dhe Polici për procedim të mëtutjeshëm, 8 raste janë përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore, 30 raste janë përcjell për procedim të mëtutjeshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, 97 raste

janë mbyllur, ndërsa 56 raste janë në procedurë.

Rastet në procedurë të gjitha janë raste të regjistruara gjatë vitit 2013. Grafiku i mëposhtëm pasqyron procedimin 319 rasteve të trajtuara gjatë vitit 2013



Grafiku 1. Pasqyrimi i procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2013

4.1.2 Rastet e përcjella në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm janë përcjell **128** informata dhe kallëzime penale.

Prej tyre në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit janë përcjellë 104 kallëzime penale, për të cilat Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka njoftuar se ato janë deleguar në kompetencë të prokurorive respektive. Në Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it janë përcjell 7 kallëzime penale, ndërsa në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion/Policia e Kosovës, janë përcjell 17 informata.


Ndërsa, në tetë (**8**) raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë veprë penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto raste i ka përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprake lidhur me bizneset e padeklaruara të cilat janë identifikuar gjatë procesit të shqyrtimit të konfliktit të interesit dhe më pas kontrollit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, pasi që ato janë konstatuar si pasive, 30 raste janë përcjell në Njësinë e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës të Administratës Tatimore të Kosovës, me qëllim të verifikimit- inspektimit nëse të njëjtat janë duke ushtruar çfarëdo lloj veprimtarie në teren. Lidhur me këto raste ATK ka ndërmarrë veprime të caktuara dhe ka dorëzuar në AKK dokumentacion relevant, i cili është në fazën e shqyrtimit.

- **Personat e dyshuar për veprime korruptive**

AKK, në **128** rastet e përcjella në prokuroritë publike dhe organet policore kompetente për procedim

të mëtutjeshëm penal pas konstatimeve se ka të dhëna të mjaftueshme apo/ dhe dyshim të arsyeshëm për përfshirjen në veprime korruptive, ka denoncuar **238** persona. Prej tyre 172 persona janë përcjell në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, 45 persona në Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it dhe 21 persona në DHKEK- Policia e Kosovës. Në 1 rast i cili është përcjell në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe në 7 raste të përcjella në DHKEK- Policia e Kosovës nuk është arritur identifikimi i personave. Për më tepër është pasqyruar në grafikun e më poshtëm .



Grafiku 2. Pasqyrimi i Kallëzimeve Penale dhe numrit të personave të përfshirë të përcjella në institucionet përkatëse

AKK gjithashtu gjatë periudhës raportuese ka përcjellë **8** raste në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër **8** personave zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ndërsa në 30 rastet e përcjella në Njësinë e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës të Administratës Tatimore të Kosovës janë të përfshirë 30 persona.

Rastet e përcjella sipas strukturës së veprave penale

Në mesin e **128** rasteve të përcjella në Prokurori dhe DHKEK- Policia e Kosovës për procedim të mëtutjeshëm, në disa prej tyre janë të përfshira dy e më shumë vepra penale. Veprat penale i përkasin kryesisht kapitullit XXXIV Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Kosovës, mirëpo nuk përjashtohen rastet kur janë përcjell me dyshime për veprime të sanksionuara në kapitujt tjerë sipas Kodit Penal të Kosovës. Ndërsa, në 9 raste, për veprimet e dyshuara nuk është arritur që të kualifikohen se çfarë figure të veprës penale paraqesin, për shkak të tejkalimit të mundësive hetimore të Agjencisë.

Struktura e veprave penale të përcjella në institucionet kompetente, është si në vijim:

Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar - Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella në Prokuroritë dhe DHKEK- Policia e Kosovës numrin e dytë më të madh të tyre e përbejnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 339, përkatësisht 422 të KPK-së. Sipas figurës së veprës penale në fjalë janë përcjell 39 informata dhe kallëzime penale të kësaj natyre. Në disa raste kjo vepër penale shoqërohet edhe me vepra tjera penale si Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë (neni

222 të Kodit Penal të Kosovës), Ushtrim i ndikimit (neni 431 të Kodit Penal të Kosovës), Falsifikim i dokumentit zyrtar (neni 434 të Kodit Penal të Kosovës), Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 432 të Kodit Penal të Kosovës), Mashtrimi (neni 335 të Kodit Penal të Kosovës), Shmangia nga tatimi (neni 313 të Kodit Penal të Kosovës), Falsifikim i dokumenteve (neni 398 të Kodit Penal të Kosovës), Mashtrimi në detyrë (neni 426 të Kodit Penal të Kosovës).

Falsifikim i dokumentit zyrtar - Sipas figurës së kësaj vepre penale e sanksionuar në nenin 348, përkatësisht 434 të Kodit Penal të Kosovës, 2 (dy) raste janë përcjell të shoqëruara së bashku me veprën penale Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 339, përkatësisht 422 të Kodit Penal të Kosovës).


Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - Numrin më të madh të rasteve të përcjella në prokurori e përbëjnë veprimet e sanksionuara sipas nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës, gjithsejtë 74 kallëzime penale.

Mashtrimi – Dy raste janë përcjell sipas figurës së kësaj vepre penale e sanksionuar në nenin 335 të Kodit Penal të Kosovës.

Falsifikimi i dokumenteve – Një rast është përcjell sipas figurës së kësaj vepre penale e sanksionuar në nenin 398 të Kodit Penal të Kosovës.

Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve - Një rast është përcjell sipas figurës së kësaj vepre penale e sanksionuar në nenin 399 të Kodit Penal të Kosovës.

Grafiku më poshtë pasqyron përcjelljen e rasteve sipas strukturës së veprës penale



Grafiku 3. Përcjellja e rasteve sipas strukturës së veprës penale

Karakteristikat e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimeve paraprake

AKK ka zhvilluar procedurën e hetimeve paraprake në lidhje me dyshimet për veprime korruptive,

pra në lidhje me veprat penale nga kapitulli XXXIV i KPK-së - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare. Përkundër një angazhimi të përgjithshëm institucional veprat penale të korrupsionit vazhdojnë të përbëjnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes por njëkohësisht përbëjnë edhe veprat penale për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime, kjo për shkak të kompleksitetit të veprës penale, mënyrës së kryerjes si dhe kryerësve të këtyre veprave penale.

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me veprën penale **Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar** nga neni 422 të KPK-së, ku janë të përfshira institucionet e Republikës së Kosovës, është shfrytëzimi i detyrës apo autoritetit zyrtar nga personi zyrtar i cili me veprim apo mosveprim shkel ligjet e aplikueshme me qëllim përfitimi të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo me qëllim të shkakutimit të dëmit për personat tjerë apo biznesin e caktuar, ose që seriozisht shkel të drejtat e personit tjetër, tejkalon kompetencat dhe nuk i përmbush detyrat zyrtare.

Në rastet më të shpeshta veprimet apo mos veprimet e përmendura, i referohen shkeljes së procedurave të prokurimit, apo në rastet më të këqija anashkalimi i tërësishëm i këtyre procedurave duke iu shmangur në këtë mënyrë transparencës dhe konkurrencës lojale. Shkeljet e procedurave të prokurimit paraqiten gjatë gjithë ciklit të prokurimit duke filluar nga planifikimi dhe përgatitja e dosjeve të tenderëve si:

- ✓ Hartimi i dosjeve të tenderëve në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren për prokurim publik;
- ✓ Caktimi i kundërligjshëm i kriterëve të përzgjedhjes me qëllim favorizimi të OE të caktuar;
- ✓ Lidhet kontratë me operatorin ekonomik, në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, për instalimin e sistemit të caktuar i cili më pas është i pashfrytëzueshëm dhe nuk përdoret asnjëherë nga institucionet të cilave iu destinohet.
- ✓ Lejimi i vazhdimit të procedurave të prokurimit dhe pse të njëjtat janë përcjell me shkelje të ligjit të prokurimit.

Në fazën e vlerësimit të ofertave paraqiten shkelje si:

- ✓ Vazhdimi i zbatimit të procedurave të prokurimit përkundër faktit se paraqitet numër më i vogël i ofertave të përgjegjshme se sa minimalja e kërkuar me ligj;
- ✓ Anëtarët e komisionit për vlerësimin e ofertave me vlerësimet e tyre dhe nënshkrimin e raportit të vlerësimit paraqesin informacione të rreme dhe vërtetojnë përmbajtjen e tij me të dhëna të rreme për operatorë ekonomik (më tutje OE) të cilët kanë dorëzuar ofertat e tyre dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës i rekomandojnë Menaxherit të Prokurimit dhënien e kontratës OE të papërgjegjshëm, i cili nuk ka staf profesional përkatës dhe veprimtaria biznesore e të cilët nuk ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për të cilat është kontraktuar, apo nuk i plotëson kushtet tjera të kërkuara ligjërisht;
- ✓ Rekomandime që me kontrata publike të shpërblehen OE të favorizuar duke eliminuar nga procedura e prokurimit OE të përgjegjshëm;
- ✓ Rekomandimi për lidhjen e kontratës me OE edhe në ato raste kur aktiviteti i prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik do të duhej të anulohet, për shkak se nuk është plotësuar kërkesa për numrin e operatorëve ekonomik të përgjegjshëm, apo ku vetëm një OE është i përgjegjshëm;

- ✓ Në raportin e vlerësimit OE nuk vlerësohen sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, por shpallen të përgjegjshëm edhe pse të njëjtit nuk i plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe rekomandohet lidhja e kontratës, ndërsa do të duhej të anulohet aktiviteti i prokurimit për faktin se asnjë OE nuk ka qenë i përgjegjshëm;
- ✓ OE i mundësohet që sigurinë e ekzekutimit të tenderit ta paguaj në vlerë më të vogël se sa siç kërkohet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë;
- ✓ Nënshkrimi i kontratës sipas aktivitetit të caktuar të prokurimit nga personat e pa autorizuar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik;
- ✓ Lidhja e kontratave publike me OE ku pronar janë persona të afërm familjar;
- ✓ Po ashtu lidhje e kontratës publike me OE që pronari i saj është bashkëpronar në një kompani tjetër me zyrtarin kryesor administrativ në institucionin si autoritet kontraktues;
- ✓ Lidhja e aneks kontratës duke tejkaluar përqindjen e vlerës së kontratës bazë të lejuar me ligj dhe mos respektimi i aprovimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit për punë shtesë i cili obligon që në përpikëri të respektohet Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë;
- ✓ Në kundërshtim me nenin 32 paragrafi 5 të Ligjit për LPP, revokohet neni 32.4, duke mos pasur asnjë arsye të bazuar për revokim.

Faza e mbikëqyrjes së realizimit të punëve, ofrimit të shërbimeve dhe furnizimit karakterizohet si:

- ✓ anëtarët e komisionit mbikëqyrës pranojnë mall i cili nuk ka qenë në përputhje me specifikat teknike ashtu sikurse është paraparë me kontratë;
- ✓ aprovim i pagesave pa u plotësuar kushtet ligjore;
- ✓ lejimi i ndryshimit të pozicioneve në para masë edhe pse me kushtet e përcaktuara në kontratë nuk lejohet ndryshimi i asnjë kushti;
- ✓ përdorimi i pjesërishëm i produkteve të blera me prokurim publik, si dhe nuk dihet vendndodhja e produkteve të papërdorura me të cilat furnizohen Autoritetet e caktuara kontraktuese;
- ✓ prezantimi i rremë i raporteve mbi përfundimin e punimeve, se punët janë kryer ashtu siç është paraparë me kontratë, duke vënë në lajthitje personat e autorizuar në kryerjen e pagesave, edhe pse punët nuk kishin përfunduar ashtu siç ishin paraparë me kontratë.

Vepra penale **Keqpërdorim i Pozitës apo autoritetit zyrtar** i karakterizon edhe rastet e hetuara për shkelje të tjera si:

- ✓ Me dashje apo me dijeni lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit, themelohen marrëdhënie të punës pa shpallur konkurs publik në kundërshtim me Ligjin e Punës;
- ✓ Dhënia e banesave në shfrytëzim me qira zyrtareve të caktuar në mënyrë të kundërligjshme;
- ✓ Mosndërmarrja e veprimeve konkrete për rrënimin e Objektivit banesor kolektiv pas nxjerrjes së aktvendimit për pezullimin e punimeve, si dhe lejimi për vazhdimin e ndërtimit në kundërshtim me Ligjin për Ndërtim edhe përkundër faktit se disa herë ndërtuesi ilegal është paralajmëruar që të ndërpres punimet dhe të siguroj lejen e ndërtimit;
- ✓ Transformimi i ngastrës kadastrale, nga prona shoqërore në pronë të Komunës, si dhe dhënia në shfrytëzim të saj në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm;
- ✓ Pranimi në punë i personave të afërt, duke diskriminuar personat të cilët i kanë plotësuar kushtet e parapara në konkurs;
- ✓ Mos ndërmarrja e veprimeve të duhura për ekzekutimin e aktvendimit me të cilin urdhërohet heqja dorë nga shfrytëzimi i pronës publike, lirimi i tokës së uzurpuar duke e kthyer në gjendje të mëparshme;

- ✓ Lejimi i kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit zyrtarë jashtë Kosovës në kundërshtim me udhëzimin administrativ për udhëtimet zyrtare për personat të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me institucionin i cili i lejon këto kompensime;
- ✓ Rekomandimi, pranimi dhe aprovimi i shpenzimeve të pa dokumentuara me dokumentacion përkatës;
- ✓ Nënshkrimi i kontratës mbi qiranë për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Disa veprime tjera të cilat e karakterizojnë këtë vepër penale për shkak të natyrës së tyre nuk janë prezantuar për faktin se publikimi i tyre do të mund të dëmtonte procesin e mëtutjeshëm të hetimeve.

Mashtrimi në detyrë sipas nenit 426 të KPK-së karakterizohet me prezantimin e rremë të raporteve mbi përfundimin e punimeve në lidhje me projektin e caktuar, ashtu që kinse punët janë realizuar sipas kontratës duke vënë në lajthim personat e autorizuar për kryerjen e pagesave, edhe pse punët nuk ishin realizuar sipas kontratës me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për punë kryesin.

Ushtrim i ndikimit sipas nenit 431 të KPK-së karakterizohet me ushtrimin e ndikimit të padrejtë nga ana e personit të caktuar zyrtarë mbi vendimmarrjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të aktivitetit të caktuar të prokurimit ashtu që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të pranon ndonjë përftim për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim.

Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore sipas neni 432 të KPK-së e karakterizon nxjerrja e vendimit të kundërligjshëm nga gjyqtari duke i shkaktuar dëm njëres palë në procedurë me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për palën tjetër.

Falsifikimi i Dokumentit Zyrtar sipas nenit 434 të KPK-së është karakteristikë e rasteve të hetuara ku dyshohet për falsifikim të dokumentacionit të aplikuesve, përkatësisht nënshkrimit, në lidhje me përfitimin e fondeve të caktuara mbështetëse nga institucionet publike të cilat tregojnë për shënim të informacionit të rremë në procesverbale të hapjes dhe vlerësimit me qëllim favorizimi të OE fitues, etj. Po ashtu problematikë paraqitet edhe çështja e vërtetimeve për kryerjen e obligimeve ndaj shtetit nga ana e OE ku janë gjetur se dokumentet e tilla janë falsifikuar në mënyrë të vazhdueshme.

Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 437 të KPK-së, është vepër penale e re e cila është përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës i cili ka hyrë në fuqi nga 01 Janar 2013. Karakteristikë e rasteve të hetuara të cilat kanë të bëjnë me këtë vepër penale është mos deklarimi i pasurisë brenda afateve të përcaktuara kohore sipas ligjit në fuqi, si dhe mos paraqitja e të dhënave të kërkuara si paluajtshmëria, pasuria e luajtshme në vlerë mbi pesëmijë (5 000) Euro, zotërimi i aksioneve në shoqëri tregtare, letrave me vlerë, para të kursyera në bankë dhe në institucione tjera financiare, detyrime financiare ndaj personave fizik dhe juridik dhe të hyrave vjetore.

Ndërsa **Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë** sipas nenit 222 të KPK-së karakterizohet me mos publikim të konkursit publik sipas ligjit, po ashtu dhe shkelje të tjera të parimeve dhe dispozitave ligjore të pranimi të kuadrit profesional në sistemin arsimor duke kërcënuar dhe zvogëluar mundësitë për konkurrencë reale dhe jo diskriminuese ndërmjet kandidatëve potencial në kushte të njëjta dhe të barabarta, përzgjedhja e kandidatëve pa kualifikime të nevojshme të

kërkuara, etj.

Shmangie nga tatimi sipas nenit 313 të KPK-së e karakterizon dështimi nga OE që kontratat me punëmarrës të cilat i ka prezantuar në kuadër të ofertës së tij si pjesëmarrës në aktivitet të caktuar të prokurimit ti paraqes në raportin tremujor para Administratës Tatimore të Kosovës për pagimin e kontributeve të mbajtura në burim dhe të paguara.

Veprën penale **Mashtrimi** sipas nenit 335 të KPK-së gjatë kësaj periudhe raportuese e karakterizon qëllimi për të përfutur kundërligjshëm dobi pasurore për vete në atë mënyrë që duke prezantuar dokumentacion të rremë para autoritetit kontraktues dhe duke i nxitur personat zyrtarë që të kryejnë veprime të dëmshme për pasurinë publike të shpallet fitues i një aktiviteti të caktuar prokurimi.

Falsifikimi i dokumenteve sipas nenit 398 të KPK-së e karakterizon dorëzimi i ofertës nga OE i caktuar në Autoritetin e caktuar kontraktues me referenca të falsifikuara duke i përdorur ato me qëllim të shfrytëzimit si dokumente origjinale për ti vënë në lajthim komisionin e vlerësimit dhe rivlerësimit të aktivitetit të caktuar të prokurimit që t'i vlerësojnë si të vërteta ato.

Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve sipas nenit 399 të KPK-së e karakterizon dyshimi se dokumentacioni i ofertave të ofruara për një aktivitet të caktuar të prokurimit është plotësuar dhe nënshkruar nga e njëjta dorë dhe është bërë pjesë e dosjes për t'iu prezantuar Agjencisë sipas kërkesës për dokumentacion, pasi që Auditori Gjeneral kishte gjetur se lidhur me këtë aktivitet gjatë auditimit i ishte ofruar dokumentacion tjetër.

Rastet e përcjella sipas vitit të kryerjes së veprimit të dyshuar korruptiv

Në periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve AKK ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive e të cilat janë përcjell për procedim penal të mëtutjeshëm në institucionet kompetente, i takojnë viteve të ndryshme të kryerjes së tyre, duke filluar nga viti 2008-2013.

Rastet e mbyllura

Gjatë kësaj periudhe raportuese AKK pas zhvillimit të procedurave hetimore paraprake ka mbyllur 97 raste. Arsyet për mbylljen e tyre janë si vijon:

- ✓ **60** raste janë mbyllur për shkak se pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të bazuar se rasti mund të përbëjë vepër penale apo shkelje administrative;
- ✓ **12** raste janë mbyllur në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, për shkak se Agjencia nuk ka pas kompetencën për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake; dhe
- ✓ **25** raste janë mbyllur për shkak se ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale nga organet kompetente, ku 7 raste nga DHKEK Policia e Kosovës, 6 raste nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, 4 raste nga Prokuroria Themelore e EULEX-it në Prishtinë, 1 rast nga Prokuroria Themelore në Prizren, 1 rast nga Prokuroria Themelore në Pejë, 1 rast nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, 2 raste nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, 1 rast nga Prokuroria

Themelore në Gjakovë, 1 rast nga Prokuroria Themelore në Gjiilan dhe 1 rast nga Njësia e Hetimeve Financiare EULEX (FIU).

Rastet anonime të paraqitura në AKK

Për personat të cilët me mirëbesim kanë zbuluar informacionin për ekzistencën e korrupsionit dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, AKK ka mundësuar që ata ti paraqesin rastet e dyshuara të korrupsionit në mënyrë anonime me qëllim të ruajtjes së identitetit të raportuesve dhe inkurajimin e qytetarëve për raportimin e këtyre rasteve. Gjatë kësaj periudhe raportuese, numri i rasteve të raportuara në mënyrë anonime dhe atyre të përcjella në institucionet kompetente nga kjo kategori është:

- ✓ Numri i përgjithshëm i informacioneve anonime të trajtuara është **43**, ku prej tyre 26 i takojnë rasteve të bartura nga vitet paraprake, ndërsa 17 rasteve të raportuara në vitin 2013.
- ✓ Numri i rasteve anonime të përcjella në prokuroritë kompetente është **gjashtë (6)** ku janë identifikuar 10 persona, në Polici janë adresuar katër raste ku janë identifikuar 2 persona, kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore për shkelje të identifikuar administrative në organin kompetent një (1) rast kundër një (1) personi, në Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it një (1) rast kundër katër (4) personave, të mbyllura 26 raste, ndërsa pesë (5) raste janë në procedurë.

Rastet e iniciuara ex-officio nga AKK


Gjatë vitit raportues Agjencia ka trajtuar gjithsejtë 48 raste të iniciuara sipas detyrës zyrtare (ex-officio). Në vitin 2013, Agjencia ka iniciuar 37 raste sipas detyrës zyrtare, ndërsa 11 prej tyre i takojnë rasteve të bartura nga vitet paraprake, e të trajtuara gjatë kësaj periudhe raportuese.

Prej tyre 12 raste janë përcjellë në prokuroritë kompetente kundër 69 personave të identifikuar, gjashtë (6) raste në DHKEK- Policia e Kosovës me gjashtë (6) persona të identifikuar, një (1) rast në Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it kundër një (1) personi, katër (4) raste janë përcjellë në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore kundër katër (4) personave, 14 raste janë mbyllur në mungesë të provave, ndërsa 11 raste janë në procedurë dhe si të tilla barten në vitin pasues.

Numri i rasteve të përcjella që nga funksionalizimi i AKK-së

AKK që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit, nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka përcjell në prokuroritë kompetente, prokurorinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës dhe Njësinë e Hetimeve Financiare, gjithsejtë **420** raste. Në vitin 2007 AKK në Institucionet Kompetente ka përcjellë 47 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 91 persona, në vitin 2008 ka përcjellë gjithsejtë 53 raste në të cilat kanë qenë të përfshirë 113 persona, në vitin 2009 AKK ka përcjellë 68 raste ku janë të përfshirë 159 persona, në vitin 2010 ka përcjellë 33 raste, ndërkaq janë të përfshirë 164 persona, në vitin 2011 ka përcjellë 39 raste të përfshirë 121 persona, në vitin 2012 janë përcjellë gjithsejtë 52 raste me përfshirje të 159 personave. Ndërsa, në vitin 2013 janë përcjellë gjithsejtë 128

raste kundër 238 personave. Në mënyrë grafike, këto të dhëna duken si më poshtë.



Grafiku 4. Numri i rasteve të përcjella në organet kompetente si dhe personat e përfshirë në to që nga 2007- 2013

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të përcjella nga viti 2007 deri 2013 në Prokuroritë Kompetente dhe Policinë e Kosovës, prokuroritë kanë dhënë informacion kthyes duke konfirmuar se 162 raste janë në procedurë hetimore, janë ngritur 13 propozim akuza dhe 33 aktakuza, 126 raste është konfirmuar se janë hedhur poshtë, ndërsa për 86 raste të përcjella nuk ka informata kthyes. Në mënyrë tabelare, këto të dhëna duken si në tabelën 1.

Nr.	Institucioni	Lëndët e përcjella	Propozim akuza	Hetime	Aktakuza	Lëndë të hedhura	Pa informata kthyes
1	PSH	13					13
2	PSRK	27		9	1	9	8
3	P. e EULEX-it	45		13	2	20	10
4	PTH. Prishtinë	162	5	84	6	52	15
5	PTH. Prizren	25	3	10	1	11	
6	PTH. Pejë	19	1	7	2	9	
7	PTH. Mitrovicë	7	1	1	2	3	
8	PTH. Gjilan	36	2	17	7	10	
12	PTH. Gjakovë	15	1	3	8	3	
15	PTH. Ferizaj	12		5	4	3	
16	Policia e Kosovës	49		12		6	31
17	IP	4					4
18	FIU	6		1			5
Gjithsej:		420	13	162	33	126	86

Tabela 1. Rastet e përcjella nëpër organet kompetente që nga funksionalizimi i AKK-së

Nga gjithsejtë 420 rastet e përcjella në Institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal numri i personave të dyshuar është: 1045 persona të identifikuar, ku në 39 prej këtyre rasteve AKK nuk ka arritur që të identifikoj personat konkret.

Në rastet për të cilët janë ngritur propozim akuza dhe aktakuza nga ana e Prokurorive kompetente janë të përfshirë gjithsejtë 48 persona.

Lidhur me rastet e përcjella, AKK ka pranuar njoftime nga Prokuroritë kompetente për ngritje të aktakuzave dhe propozim akuzave qysh në vitin 2008, por në fakt përveç informacionit se janë ngritur aktakuza AKK nuk ka marr informacion shtesë për procedimin e mëtutjeshëm të tyre. Sidoqoftë numri i aktakuzave që AKK ka marr informacion nga Prokurorit se janë ngritur nga rastet e Agjencisë sipas viteve janë kështu: - në vitin 2008 janë ngritur 3 aktakuza, në vitin 2009, 4 aktakuza, në vitin 2010, 2 aktakuza, në vitin 2011, 7 aktakuza, në vitin 2012, 7 aktakuza, si dhe në vitin 2013, 33 aktakuza dhe 13 propozim akuza.

Mënyra e hedhjes poshtë të rasteve nga Prokurorit

Duke parë trendin në rritje të rasteve të hedhura poshtë nga ana e prokurorive kompetente prej viti në vit është parë si e domosdoshme nga AKK vlerësimi i kësaj situate. Në shumicën e rasteve të hedhura poshtë, zyrtarët e AKK-së nuk janë ftuar nga ana e Prokurorive Kompetente për të mbrojtur kallëzimet penale të ngritura nga ta, për dallim nga prokuroritë e EULEX-it të cilat që në fazën e parë të hetimeve dhe gjatë gjithë procedurës ftojnë zyrtarët e AKK-së lidhur me këto kallëzime penale. Prokuroritë lidhur me rastet e përcjella nga AKK tek të njëjtat, kanë kërkuar nga AKK që të provojë qëllimin e veprave penale si element konstituiv i figurës së tyre, përderisa në asnjë rast edhe përkundër mundësive ligjore të njëjtat nuk kanë ndërmarr veprime hetimore të nevojshme dhe nuk kanë arritur që të provojnë vet qëllimin.

Në shumicën e arsyetimeve të rasteve të hedhura poshtë, prokuroritë kompetente theksojnë se dyshimet e AKK për kryerje të veprave penale me natyrë korruptive nuk paraqesin vepra penale por të njëjtat konsiderohen dhe konstatohen shkelje administrative. Andaj duke i konsideruar si të tilla pushohen hetimet duke pamundësuar hetimet e mëtutjeshme për dyshimet e ngritura nga AKK. Tek disa raste të ngritura me kallëzime penale nga AKK, skadon afati i ndjekjes penale apo është bërë parashkrimi i ndjekjes së veprave penale për shkak të neglizhencës së Prokurorive Kompetente. Po ashtu, në disa raste Prokuroritë Kompetente injorojnë provat e paraqitura së bashku me kallëzimet penale nga ana e AKK-së.

Prokuroritë në shumicën e rasteve hedhjen poshtë të rasteve apo pushimin e hetimeve e kanë mbështetur kryesisht në raportet e veçanta të ofruara nga Policia e Kosovës. Në shumicën e rasteve kur Prokuroritë kanë hedhur poshtë apo kur kanë pushuar hetimet, sipas arsytimit mund të nxirret si konkludim se njohuritë e Prokurorëve rreth Ligjit të Prokurimit janë bazike dhe shkeljet e tij nuk trajtohen drejtë, ngase dëmi i shkaktuar si pasojë e këtyre shkeljeve mbetet i pa sanksionuar.

Ekspertizat të cilave Prokuroritë ia falin besimin në rastet e dyshuara për shkelje gjatë procedurave të prokurimit publik, e të cilat megjithëse konstatojnë shkelje, i arsyetojnë ato se kontratat fitohen nga OE të cilët ofertojnë me çmime më të lira, pa vlerësuar cilësinë e në disa raste edhe sasinë e ofruar për punët, shërbimet dhe furnizimet e kontraktuara.

4.1.3 Bashkëpunimi me institucionet tjera që kanë për mision luftën kundër korrupsionit

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme dhe disa rezultateve të lehta që janë arritura kohëve të fundit në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, kjo çështje vazhdon të mbetet një sfidë për Agjencinë. Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional paraqitet si ndër pengesat kryesore në arritjen e rezultateve të pritshme.

AKK ka rekomanduar si nevojë krijimin e një trupi koordinues të përbashkët të të gjitha institucioneve anti korrupsion që veprojnë në Kosovë ku do të përfaqësoheshin në nivel të krerëve institucional. Krijimi i një trupe të tillë është paraparë si veprim konkret edhe në planin e veprimit kundër korrupsionit 2013-17.

Bashkëpunimi me Prokuroritë sa i përket informatave kthyesë tek Agjencia për procedimin e mëturjes dhe vendimin final lidhur me rastet e përcjella është përmirësuar. Në shumicën e rasteve AKK ka pranuar njoftime me shkrim nga Prokuroria. Brenda afateve të arsyeshme kohore AKK ka pranuar konfirmime nga ana e Prokurorive dhe Policisë së Kosovës nëse në rastet e njëjta të raportuara në AKK është iniciuar dhe zhvillohet procedura penale në mënyrë që rastet e njëjta të mos hetohen në të njëjtën kohë nga dy institucione dhe të mos zhvillohen dy procedura të ndara.

Brenda kompetencave ligjore AKK ka shkëmbyer informacion dhe dokumentacion me të gjitha institucionet tjera që kanë për mision luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Në këtë kuptim AKK ka ofruar informacione për institucionet kompetente lidhur me verifikimin e të kaluarës së personave të caktuar. Gjatë periudhës raportuese Prokuroritë e EULEX-it kanë autorizuar AKK për të ndërmarrë veprime hetimore brenda kompetencave të AKK-së. AKK ka qenë pjesë konstruktive e të gjitha nismave të institucioneve të tjera të cilat për qëllim kanë pasur përmirësimin e bashkëpunimit. Vlen të ceket edhe pjesëmarrja aktive në organizimet e trajnimeve dhe punëtorive të përbashkëta.

4.2 Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017

Strategjia kundër korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2013-2017 janë dy dokumente të politikave anti korrupsion, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës në shkurt të 2013. Plani i Veprimit është projektuar për të zbatuar objektiva konkrete strategjike përmes masave specifike dhe konkrete kundër korrupsionit. Ai përbëhet nga objektivat specifike të plan-veprimit, masave apo veprimeve së bashku me treguesit e suksesit dhe janë përcaktuar afatet kohore.

AKK është përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të Strategjisë nëpërmjet masave të parashikuara në Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit.


Me 27 maj 2013, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) kërkoi nga pikat e kontaktit të përfshira në Planin e Veprimit që deri më 5 qershor 2013, të paraqesin raporte për periudhën kohore 11 shkurt - 27 maj 2013, mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2013-2017¹. Në procesin e raportimit kanë qenë të përfshirë institucionet qendrore dhe lokale publike, sektori privat dhe shoqëria civile.

¹ Pika e Kontaktit - është person përgjegjës i cili raporton në AKK për Institucionin nga i cili vjen.

Shih më gjësisht, Raportin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit kundër Korrupsionit për periudhën shkurt- maj 2013: <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti%20per%20Monitorimin%20e%20SPV.pdf>

Po ashtu me datë 16.01.2014, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) kërkoi nga pikat e kontaktit të përfshira në Planin e Veprimit që deri më 29.01.2014, të paraqesin raporte për periudhën kohore qershor – dhjetor 2013 mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2013-2017.

Për periudhën raportuese, qershor - dhjetor 2013, Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2013-2017 ka dhënë një total prej 155 veprimeve. Institucionet përgjegjëse gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë raportuar fare për 46 veprime ose në përqindje 30%. Për 109 veprime të tjera të raportuara nga institucionet dhe në bazë të raporteve të marra, AKK ka nxjerr një përfundim se 66 veprime janë realizuar apo janë në realizim e sipër ose në përqindje 42%, 18 veprime janë pjesërisht të realizuara ose 12% dhe 25 veprime janë të pa realizuara ose 16%, siç janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 5. Realizimi i masave të Planit të veprimit kundër korrupsionit nga insitucionet e Kosovës

Tabela në vijim tregon pikat e kontaktit që kanë raportuar dhe nuk kanë raportuar në lidhje me zbatimin e objektivave dhe veprimeve që dalin nga Plani i Veprimit për periudhën qershor - dhjetor 2013.

Nr.	Pikat e Kontaktit që kanë raportuar për periudhën Qershor – Dhjetor 2013	Pikat e Kontaktit që nuk kanë raportuar fare për periudhën Qershor – Dhjetor 2013
1.	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	Organizata “FOL”
2.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Organizata “KDI”
3.	Policia e Kosovës	Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës
4.	Zyra për Qeverisje të Mirë	Oda Ekonomike e Kosovës
5.	Këshilli Prokurorial i Kosove	
6.	Dogana e Kosovës	
7.	Auditori i Përgjithshëm	
8.	Administrata Tatimore e Kosovës	
9.	Ministria e Shëndetësisë	
10.	Inspektorati Policor i Kosovës	
11.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
12.	Ministria e Drejtësisë	

13.	Kuvendi i Kosovës	
14.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	
15.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	
16.	Agjencia Kosovare e Privatizimit	
17.	Agjencia kundër Korrupsionit	
18.	Instituti Kombëtar për Administratën Publike	
19.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	
20.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	
21.	Organi shqyrtues i Prokurimit Publik	
22.	Komisioni i Pavarur i Mediave	
23.	Ministria e Administratës Publike	
24.	Ministria e Financave	
25.	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës	

Tabela 2. Pasqyron pikat e kontaktit që kanë raportuar dhe nuk kanë raportuar në lidhje me zbatimin e objektivave që dalin nga Plani i Veprimit për periudhën qershor – dhjetor 2013

Raporti i detajuar në lidhje me zbatimin e veprimeve kundër korrupsionit nga pikat e kontaktit për periudhën qershor – dhjetor 2013 është paraqitur në formë tabelore ([Shtojca B1](#)).

4.3 Avancimi i kuadrit ligjor dhe vetëdijesimi i Publikut

Agjencia kundër Korrupsionit, në vitin 2013 ka iniciuar procesin e avancimit të kuadrit ligjor që e zbaton për përmbushjen e misionit të saj. Me qëllim të përshtatjes së ligjeve që i zbaton Agjencia me zgjidhjet e reflektuara në Kodin nr. 04/L-082 Penal, është punuar në legjislacionin parësor. Në kuadër të legjislacionit parësor, është në procedurë ndryshimi dhe plotësimi i:

1. Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë;
2. Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë proces, Agjencia ka marrë pjesë aktivisht në grupet punuese dhe diskutimet e realizuara në Ministrinë e Drejtësisë por edhe në Kuvendin e Kosovës në lidhje me këto akte. Gjatë zbatimit të këtyre ligjeve në praktikë, Agjencia i ka identifikuar mangësitë konkrete dhe ka dhënë propozimet që të njëjtat të mënjanohej përmes zgjidhjeve që do të përfshihen në këto ligje, për të lehtësuar zbatimin e tyre në praktikë.

Gjatë vitit 2013, Agjencia ka shtuar angazhimet për hartimin e legjislacionit dytësor. Në kuadër të legjislacionit dytësor, janë përgatitur dhe miratuar këto akte:

1. Rregulloja nr. 01-2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë kundër Korrupsionit;
2. Rregullorja nr. 02/2013 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit;
3. Kodi nr. 03/2013 të Etikës për Nëpunësit e Agjencisë kundër Korrupsionit;
4. Rregullorja nr. 04/2013 për Organizimin, Funkcionimin dhe Menaxhimin e Arkivit të Agjencisë kundër Korrupsionit.

AKK, gjatë vitit 2013 ka synuar që përmes formave të ndryshme të sensibilizimit të cilat kanë informacione të nevojshme, të krijojnë një ambient të ndërgjegjësimit, përgjegjësisë, optimizmit dhe gatishmërisë së publikut për të mbështetur luftën kundër korrupsionit (raporte, opinione, debate publike, trajnime etj.)

Në bashkëpunim me Misionin e Bashkimit Evropian [për Sundimin e Ligjit EULEX, Agjencia filloj fushatën një mujore vetëdijesuese, për zyrtarët e lartë publik, përkritazi me masat e reja ndëshkuese që ka paraparë Kodi Penal i Kosovës për mos deklarimin e pasurisë apo deklarimin e rrem të saj.

Spoti televiziv është transmetuar për një muaj rresht në televizionet nacionale me qëllim që zyrtarët e lartë publik të kenë informatat e sakta në lidhje me masat që do të merren kundër atyre që nuk e bëjnë deklarimin e pasurisë apo e deklarojnë atë në mënyrë të rrejshme.

5. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e Parandalimit të Korrupsionit në Agjenci, zhvillohen nga Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit. Në pajtim me mandatin e dhënë me Ligjin nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Ligjin nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, si dhe Ligjin nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Puna e Departamentit për Parandalim është e përqendruar në këto drejtime: Mbikëqyrja dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave; Parandalimi i konfliktit të interesit dhe Parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik.

5.1 Mbikëqyrja dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave

Baza ligjore në të cilën AKK e mbështet punën e vet për mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është e definuar në Ligjin Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë.

AKK mbikëqyrë pasurinë e zyrtarit të lartë publik në bazë të informacionit të dorëzuar nga zyrtarët e lartë publik në formular të posaçëm, i cili është përgatitur nga AKK në pajtim me ligjin në fuqi. Formularët duhet të plotësohen nga zyrtarët e lartë publik dhe të dorëzohen në AKK.

5.1.1 Llojet e deklarimit të pasurisë

Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, përcakton këto lloje të deklarimeve:

- Deklarimi i rregullt vjetor;
- Deklarimi me marrjen e detyrës;
- Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë;
- Deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

Deklarimi i rregullt vjetor - Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarin e rregullt vjetor të pasurisë gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik dhe në afate të përcaktuara me ligj, zyrtarët e lartë publik detyrohen të deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në AKK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti. Për këtë periudhë kohore ose deklarin e rregullt vjetor për vitin 2013 kanë pasur për obligim që ta bëjnë deklarin e pasurisë së tyre 3869 zyrtar të lartë publik. Prej këtij numri të përgjithshëm deklarin e kanë bërë 3840 zyrtar, ose 99.25% kurse deklarin nuk e kanë bërë 29 zyrtar ose 0.75%. Kjo situatë shënon rastin më të mirë të përgjigjes pozitive të obligimit ligjor që mund të ketë ndodhur në çdo vend ku bëhet deklari i pasurisë ngjashëm sikurse në Republikën e Kosovës.

Procesi i deklarimit të rregullt vjetor për periudhën raportuese në formën tabelore duket kështu:

Institucionet	Numri i zyrtarëve që kanë pasur për obligim deklarin e pasurisë	E kanë deklaruar		Nuk e kanë deklaruar	
		Nr. i zyrtarëve	Përqindjet	Nr. i zyrtarëve	Përqindjet
Presidenca	16	16	100%	0	0%
Kuvendi	137	136	99.27%	1	0.73%
Qeveria	1075	1070	99.53%	5	0.47%
Gjykatat	374	374	100%	0	0%
Prokuroritë	125	125	100 %	0	0%
Institucionet e Pavarura	382	381	99.74	1	0.26%
Komunat	1481	1461	98.65%	20	1.35%
Ndërmarrjet Publike	279	277	99.28%	2	0.72%
TOTALI	3869	3840	99.25%	29	0.75%

Tabela 3. Rezultati i Deklarimit të rregullt vjetor.

Pasqyrimin e zyrtarëve të lartë publik të cilët obligohen që ta deklarojnë pasurinë, por që se kanë bërë një gjë të tillë, e kemi pasqyruar me anë të kësaj tabele([Shtojca B2](#)).

Deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë me shkrim pasurinë e tyre brenda afatit ligjor. Organi i punësimit është i detyruar që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor ta njoftoj AKK për fillimin apo përfundimin e punës së zyrtarit të lartë publik, ndërsa zyrtari i lartë ka për obligim deklarin e pasurisë brenda periudhës 30 ditshme pas marrjes së detyrës zyrtare.

Gjatë vitit raportues 173 zyrtar të lartë publik kanë pasur për obligim deklarin e pasurisë me marrjen e detyrës. Prej këtij numri të përgjithshëm 172 e kanë bërë deklarin e pasurisë ose 99.42%, ndërsa nuk e kanë deklaruar vetëm 1 rast ose 0.57%. Procesi i deklarimit të pasurisë me marrjen e detyrës për periudhën raportuese në formën tabelare duket kështu:

Institucionet	Numri i zyrtarëve që kanë pasur për obligim deklarin e pasurisë	E kanë deklaruar		Nuk e kanë deklaruar	
		Nr. i zyrtarëve	Përqindjet	Nr. i zyrtarëve	Përqindjet
Presidenca	2	2	100 %	0	0 %
Kuvendi	3	3	100 %	0	0 %
Qeveria	122	122	100 %	0	0 %
Gjykatat	3	3	100 %	0	0 %
Institucionet e Pavarura	10	10	100 %	0	0 %

Komunat	14	13	92.9 %	1	7.1 %
Ndërmarrjet Publike	19	19	100 %	0	0 %
TOTALI	173	172	99.42 %	1	0.57 %

Tabela 4. Rezultati i deklarimit me marrjen e detyrës.

Deklarimi sipas kërkesës së Agjencisë - AKK në çdo kohë mund të kërkojë nga zyrtari i lartë publik deklarimin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre në pajtim me ligjin. Gjatë kësaj periudhe raportuese AKK ka kërkuar nga 72 zyrtar të lartë publikë informata shtesë lidhur me deklarimin e gjendjes së pasurisë.

Procesi i deklarimit të pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë për periudhën raportuese në formën tabelare duket kështu:

Institucionet	Numri i zyrtarëve që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë	E kanë deklaruar		Nuk e kanë deklaruar	
		Nr. i zyrtarëve	Përqindjet	Nr. i zyrtarëve	Përqindjet
Presidenca	1	1	100 %	0	0 %
Kuvendi	2	2	100 %	0	0 %
Qeveria	19	19	100 %	0	0 %
Institucionet e Pavarura	23	23	100 %	0	0 %
Komunat	22	22	100 %	0	0 %
Ndërmarrjet Publike	5	5	100 %	0	0 %
TOTALI	72	72	100 %	0	0 %

Tabela 5. Rezultati i Deklarimit sipas kërkesës së AKK-së.

Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni - Pas përfundimit të funksionit në pozitën e lartë publike, zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarimin e pasurisë brenda afatit tredhjet (30) ditor.


Gjatë kësaj periudhe deklarimin e pasurisë pas largimit nga funksioni publik kanë pasur për obligim ta bëjnë 106 zyrtar. Prej tyre 101 e kanë bërë deklarimin brenda afatit ligjor dhe llogaritur në përqindje i bje se 95.28% e kanë bërë deklarimin kurse 5 zyrtar nuk e kanë bërë deklarimin ose 4.72%. Procesi i deklarimit të pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni për periudhën raportuese në formën tabelare duket kështu.

Institucionet	Numri i zyrtarëve që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë	E kanë deklaruar		Nuk e kanë deklaruar	
		Nr. i zyrtarëve	Përqindjet	Nr. i zyrtarëve	Përqindjet
Presidenca	0	0	0 %	0	0 %
Kuvendi	1	1	100 %	0	0 %
Qeveria	46	46	100 %	0	0 %
Gjykatat	10	7	70 %	3	30 %
Institucionet e Pavarura	16	15	94 %	1	6 %
Komunat	26	25	96.15%	1	3.85 %
Ndërmarrjet Publike	7	7	100 %	0	%
TOTALI	106	101	95.28 %	5	4.72 %

Tabela 6. Rezultati i Deklarimit të pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni publik.

Gjatë muajit prill, maj dhe qershor, AKK ka bërë procesimin dhe regjistrimin e të gjitha të dhënave të paraqitura nga zyrtarët e lartë publik në bazën e të dhënave të AKK-së dhe janë krijuar regjistrat në pajtim me ligjin, dhe të njëjtit janë publikuar në faqen zyrtare të AKK-së. Po ashtu janë publikuar edhe listat e atyre të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë konform ligjit.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron kompletë sistemin e procesit të deklarimit të pasurisë përgjatë gjithë vitit raportues.



Grafiku 6. Rezultati i procesit të tërësishëm të deklarimit të pasurisë për gjatë periudhës raportuese

• Kontrolli i deklarimit të pasurisë

Bazuar në mandatin që ka, AKK ka zhvilluar kontrollin paraprak dhe kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga zyrtarët e lartë publik.

Kontrolli paraprak - Kontrolli paraprak kryhet për çdo formular për të verifikuar ekzistimin/ apo mos ekzistimin e gabimeve materiale ose plotësimeve të gabuara të formularit. Gjatë regjistrimit të të dhënave në data bazë kemi bërë edhe kontrollin paraprak, ku kemi vërejtur shumë gabime në plotësimin e formularëve për deklarim të pasurisë, gabime më të theksuara i kemi vërejtur tek zyrtarët e lartë publik që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë. Në rastet kur kemi vërejtur gabime të vogla apo gabime të cilat kemi pasur mundësi përmirësimi përmes kontaktit telefonik, ne i kemi kontaktuar dhe i kemi evituar ato gabime teknike. Në rastet më të theksuara ju kemi drejtuar me shkresë zyrtare. Në 530 raste kemi vërejtur gabime teknike tek formularët për deklarim të pasurisë së paraqitur, 458 zyrtarë të lartë publik i kemi kontaktuar përmes telefonit dhe i kemi evituar gabimet teknike, ndërsa 72 zyrtarë të lartë publik ju kemi drejtuar me shkresë zyrtare për evitimin e gabimeve teknike.

Kontrolli i plotë - Kontrolli i plotë kryhet për ta verifikuar vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara në formular. AKK ka obligim ligjor për të zhvilluar kontrollin e plotë për zyrtarët e lartë publikë të cilët deklarojnë pasurinë. Gjatë periudhës raportuese AKK ka bërë kontrollin e plotë për 40.09% nga numri i përgjithshëm i formularëve të pranuar. Ndërsa për periudhën tre vjeçare

kontrolli i plotë i'u është bërë të gjithë zyrtarëve të lartë publik.

AKK ka bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuar nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjenci Kadastrale e Kosovës, Ministria e Administratës Publike, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë janë kontrolluar 1551 formular, ku në 51 raste janë vërejtur ndryshime dhe kemi kërkuar informacione shtesë, ndërsa 5 janë përcjellë për trajtim si raste të mundshme të Konfliktit të Interesit.


Tabela e mëposhtme pasqyron krahasimet nëpër vite si rezultat i kontrollit plotë të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Institucionet	Numri i zyrtarëve që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë	Të kontrolluara	Përqindjet	Ndryshimet
Presidenca	16	16	100 %	1
Kuvendi	137	45	32.8 %	1
Qeveria	1075	140	13 %	10
Gjykatat	374	374	100 %	12
Prokuroritë	125	125	100 %	2
Institucionet e Pavarura	382	375	98.2 %	12
Komunat	1481	233	15.7 %	6
Ndërmarrjet Publike	279	243	87.1 %	7
TOTALI	3869	1551	40.09 %	51

Tabela 7. Deklarimi i plotë dhe krahasimi i nëpër vite.

Për të pasur një pasqyrë shumë më të çartë rreth saktësisë së deklarimeve, - AKK ka kërkuar informacione shtesë lidhur me të hyrat vjetore të zyrtarëve të lartë publik nga: Ministria e Administratës Publike, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Oda e Avokatëve të Kosovës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Gjatë krahasimit të të hyrave vjetore të deklaruara në formularët për deklarim të pasurisë me listat e pagave të pranuar nga institucionet e lartë përmendura për të hyrat vjetore të marra në vitin 2012, dhe kemi gjetur se; - tek të hyrat vjetore financiare (pagat, mëditjet apo honorarët etj) ka pasur mos përputhje në mes deklarimeve të paraqitura në formular dhe të dhënave që Agjencia ka siguruar nga institucionet e lartë përmendura. Gjatë kësaj periudhe janë kontrolluar të hyrat e 863 zyrtarëve të lartë publik (120 nga Kuvendi, 244 nga Qeveria, 374 nga Gjykatat dhe 125 nga Prokuroria) dhe në 19 raste janë identifikuar deklarime të rreme. Përveç rasteve që Agjencia i ka trajtuar ex-officio ka edhe 10 raste të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme. Prej këtyre 10 rasteve 5 raste kanë të bëjnë me zyrtarët e qeverisë, 4 raste për Gjykatat, dhe 1 rast për Komunat), kurse 42 raste janë trajtuar të bartura nga divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron procesin e përgjithshëm të deklarimit të pasurisë, si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë.



Grafiku 7. Procesi i përgjithshëm i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Rastet e Iniciuara në gjykatat për kundërvajtje për vitet 2010, 2011, 2012

Bazuar në legjislacionin në fuqi që nga vitet 2010-2012 mos deklarimi i pasurisë është kualifikuar si veprim kundërvajtës, andaj Agjencia ka paraqitur 471 procedura kundërvajtëse për tri vite me radhë dhe ka përfaqësuar këto raste në gjykatat kompetente.

Gjendja e përgjithshme e inicimit të procedurave kundërvajtëse të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Vitet	Numri i rasteve	Aktvendimet shkalla e parë		Aktvendimet shkallë e dytë		Rastet e pezulluara		Rastet e shqiptuara masa e Qortimit		Ankesat e paraqitura	Rastet që nuk kemi pranuar informacione
		Numri i rasteve	Shuma e denimeve	Numri i rasteve	Shuma e denimeve	Shkalla e parë	Shkalla e dytë	Shkalla e parë	Shkalla e dytë		
2010	77	61	26,050 €	22	2,600 €	20	4	0	1	2	16
2011	88	78	28,010 €	16	5,500 €	10	3	11	0	10	10
2012	306	257	78,970 €	58	12,500 €	86	6	36	2	46	46
Totali	471	396	133,030 €	96	20,600 €	116	13	47	3	58	72

Tabela 8. Sanksionimi i mos deklarimit të pasurisë ndër vite (2010, 2011, 2012).

Katalogu i dhuratave

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-050 Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në AKK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

Dorëzimi i katalogut të dhuratave

Agjencia kundër Korrupsionit, gjatë muajit mars ka pranuar njoftimin nga tetë (8) institucione të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata, ndërsa njëzet e shtatë (27) institucione tjera kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit 2012.

Kontrolli i Dhuratave

Në bazë të Ligjin nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, Agjencia për herë të parë ka filluar të bëjë vizita institucioneve dhe të shohë nga afër se si institucionet i mbajnë dhe i evidentojnë dhuratat e pranuar.

Gjatë vitit 2013 kemi vizituar 22 institucione qendrore dhe 28 institucione të pavarura duke filluar nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, 19 Ministrive si dhe të gjitha institucionet e pavarura.

Qëllimi i vizitës së zyrtarëve të Agjencisë ka qenë që të shohim nga afër se si po zbatohen dispozitat e nenit 12 të ligjit 04/L-050, lidhur me mbajtjen dhe raportimin e katalogëve të dhuratave.

Të dhënat e specifikuara lidhur me katalogët dhe regjistrin e dhuratave sipas institucioneve që mbajnë dhe kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK, janë të paraqitura në tabelën si: ([Shtojca B3](#)).

Nga vizitat e realizuar në këto institucione kemi vërejtur se ka shumë mospërputhje ndërmjet numrit të dhuratave të deklaruar pranë AKK-së, siç shihet edhe nga raportet vjetore dhe të dhënave nga zyrtarët kontaktues apo të personelit.

E metë tjetër është edhe mos mbajtja e regjistrit të dhuratave nga pjesa dërmuese e këtyre institucioneve dhe mos koordinimi sa i përket dhuratave të deklaruar nga zyrtarët e këtyre institucioneve dhe zyrtarëve të personelit.

Agjencia konsideron se nevojitet një përgjegjësi më e madhe nga zyrtarët të cilët pranojnë dhurata për ta plotësuar katalogun e dhuratave dhe për ta deklaruar atë te zyrtarët kontaktues të AKK-së në institucionin të cilit ata i përkasin.

Po ashtu është shumë e nevojshme që zyrtarët e personelit apo pikat kontaktuese që të mbajnë regjistrë të dhuratave pavarësisht se ka apo nuk ka dhurata të deklaruar nga zyrtarët e institucioneve ngase është obligim ligjor mbajtja e regjistrit.

5.2 Parandalimi i konfliktit të interesit

AKK edhe gjatë vitit 2013 përmes Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit e ka rritur dukshëm performancën sa i përket identifikimit dhe trajtimit të rasteve të Konfliktit të Interesit. Edhe këtë vit duke u bazuar edhe në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionin publik, aktiviteti i këtij Divizioni është orientuar fuqishëm në dy drejtime: se pari në parandalimin e këtij konflikti dhe se dyti në luftimin e këtij fenomeni duke evidentuar rastet e dyshuara për konflikt të pastaj duke kërkuar nga institucionet apo nga zyrtarët e lartë që t'i shmangen konfliktit të interesit, si dhe dërgimin e rasteve konkrete në organet kompetente atëherë kur

konstatohen shkelje të detyrimeve ligjore.

Burimet e identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit - Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, AKK shfrytëzon shumë burime me anë të të cilave mund të identifikoj konfliktin e mundshëm të interesit.

Si burime kryesore të identifikimit të rasteve të konfliktit të interesit janë: formularët e deklarimit të gjendjes së pasurisë, mediat (elektronike apo të shkruara), ankesat e qytetarëve, regjistrat e ndryshëm zyrtar. Ekzistojnë edhe burime tjera zyrtare që i shfrytëzon AKK siç janë: bashkëpunimi me institucione publike që i ndihmojnë shumë AKK në punën e saj siç është: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve etj.

Rastet e konfliktit të interesit gjatë vitit 2013 - Në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe në përgjithësi të Ligjit Kundër Korrupsionit, Divizioni për parandalimin e konfliktit të interesit ka zhvilluar aktivitete të caktuara që për qëllim ka pasur paralajmërimin e zyrtareve të lartë për shmangien nga konflikti i interesit.

Gjatë periudhës raportuese AKK ka ofruar për interpretim, trajtim apo zgjidhje në **total prej 238** raste të dyshimit për konflikt të interesit. I gjithë procesi ka kaluar përmes një bashkëpunimi që AKK ka me Institucionet Publike, Autoritetet Përgjegjëse, me Nëpunësit Publikë, me median, shoqërinë civile, si dhe përmes informacioneve të marra nga burime të ligjshme.

Tabela në vijim pasqyron gjithë procesin dhe rastet e trajtuara për konflikt të interesit gjatë vitit 2013.


Institucioni	Rastet të paraqitura për Konflikt të interesit	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste Pa Konflikt Interesi	Raste ende në procedim	Rastet e përcjella për hetim	Kërkesa për shkarkim/kundër vajtje	Opinion
Qeveria	110	55	13	25	7	0	10
Kuvendi i Kosovës	15	6	0	8	0	0	1
Gjykata /Prokuroria	11	5	0	5	0	0	1
Agjenci të pavarura	32	17	3	7	1	0	4
Ndërmarrje Publike	30	22	4	2	0	1	1
Pushteti Lokal	40	23	7	6	1	0	3
TOTALI	238	128	27	53	9	1	20

Tabela 9. Pasqyra e gjithë procesit të rasteve të trajtuara për konflikt të interesit

Funksionet e shumëfishta

Gjatë kontrollit të plotë të formularëve të deklarimit të pasurisë janë identifikuar zyrtarë të lartë të që ushtrojnë dy e më shumë funksione. Kjo dukuri në aspektin ligjor nuk përbën vepër penale por mund të paraqet një rrezik potencial të burimit të Konfliktit të Interesit.

Grafi në vazhdim pasqyron rastet e zyrtarëve të lartë që ushtrojnë dy e më shumë funksione



Grafiku 8. Numri i zyrtarëve që ushtrojnë më shumë se një funksion

Elaborimi i disa rasteve të veçanta

Në vijim paraqiten disa shembuj të zyrtarëve të lartë publik të cilët ushtrojnë më shumë se dy funksione:

- Një zyrtarë i lartë evidentohet se mbanë 5 (pesë) vende pune, - 3 (tre) vende në Universitete, 1 (një) në një Ministri, dhe 1 (një) në një Bord;
- Një udhëheqës i një mekanizmi të pavarur, evidentohet edhe si zyrtarë i Prokurorisë, si kontabilist dhe trajner me 5 (pesë) vende pune;
- Një anëtarë bordi, me pozitë tjetër të zyrtarit të lartë, mban edhe 2 (dy) funksione si këshilltarë dhe 1 (një) pozitë si profesor, me 5 (pesë) vende pune;
- Një Menaxher në Ministri, evidentohet edhe në 3 (tre) firma të kontabilitetit me 4 (katër) vende pune;
- Një Sekretar organizativ ushtron edhe 3 (tre) vende tjera pune, gjithsejtë 4 vende pune;
- Katër (4) Auditor ushtrojnë nga dy vende pune;
- Njëzet (20) Anëtarë Bordi ushtrojnë nga 3 (tre) vende pune, 4 (katër) ushtrojnë nga 4 (katër) vende pune dhe 1 (një) ushtron 5 (pesë) vende pune;
- Njëzetedy (22) zyrtarë të lartë të Institucioneve të pavarura në mesin e të cilëve edhe kryeshefa ushtrojnë nga 3 (tre) vende pune, 3 (tre) nga 4 (katër) vende pune dhe 1 ushtron 5 (pesë) vende pune;
- Shtatë (7) Auditor të Brendshëm evidentohen të cilët ushtrojnë nga 2 (dy) vende pune, dhe 2 (dy) të cilët ushtrojnë nga 3 (tre) vende pune;
- Njëzetënjë (21) Gjyqtarë të të gjitha Gjykatave ushtrojnë nga 3 (tre) vende pune, 1 (një) i cili ushtron 4 (katër) vende pune, dhe 38 (tridhjetë e tetë) nga 2 (dy) vende pune;
- Nëntëmbëdhjetë (19) Këshilltarë të lartë me nga 3 (tre) pozita, dhe 1 (një) me 4 (katër) pozita;

- Pesë (5) Prokuror me nga 3 pozita, tre(3) me nga 4 pozita, dhe 15 prokuror me nga 2 (dy) pozita;
- Një (1) Menaxher Kontabiliteti me 4 vende të punës;
- Një (1) Menaxher i Prokurimit me 3 vende pune.

Të gjitha këto raste janë trajtuar në Agjenci, me qëllim që të garantohet mbrojtja e interesit publik në raport me interesin privat.

5.3 Parandalimi i Korrupsionit në aktivitetet e Prokurimit Publik

Aktivitetet e parandalimit të korrupsionit në fushën e prokurimit publik nga ana e Agjencisë i zhvillon Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

Për realizimin e këtyre aktiviteteve Agjencia mbështetet fillimisht në Ligjin mbi Agjencinë, Ligjin mbi Konfliktin e Interesit si dhe mbi monitorimin e zbatueshmërisë së këtij kuadri ligjor: Ligjin mbi Prokurimit Publik, Ligjin për Partneritetet Publiko-privat, Ligjin për Standardizimin, Ligjin për shoqëritë tregtare, Ligjin për Administratën Tatimore, Ligjin për markat si dhe ligjeve tjera që janë relevante për Parandalimin e Korrupsionit.

Me qëllim të parandalimit të korrupsionit AKK ka trajtuar shumë burime dhe ka intervenuar në rastet kur ka pasur dyshim se ka mosrespektim të ligjit në fushën e Prokurimit Publik

Gjatë vitit raportues ka trajtuar gjithsej 63 lëndë në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimit publik. Gjatë trajtimit të tyre, 28 raste janë ofruar Opinione parandaluese; **1 rast është ofruar opinion informues (për të gjitha autoritet kontraktuese)**; 10 raste janë mbyllur pa as një propozim; 10 raste AKK ka marr pjesë si vëzhgues, 11 raste janë përcjellë në Departamentin për Luftimin e Korrupsionit; 3 raste janë në procedurë trajtimi.

Tabela e mëposhtme pasqyron saktë rastet të cilat Agjencia i ka trajtuar gjatë vitit 2013 në fushën e parandalimit të korrupsionit në Prokurimin Publik

Lëndë të trajtuara	Opinione	Opinion informues	Pa propozim	Vëzhgues	Të përcjella për hetime në DLK	Në procedurë
63	28	1	10	10	11	3

Tabela 10. Rastet e trajtuara për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik

Në 28 opinionet e ofruara nga AKK drejt Autoriteteve Kontraktuese (Institucionet Publike), 28 raste janë respektuar rekomandimet e AKK për ndërprerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Tabela në vijim pasqyron rastet në të cilat është ndërprerë aktiviteti i prokurimit pas Rekomandimeve të AKK-së.

Nr.	Institucionet	Emri i tenderit	Vlera e tenderit
1.	Komuna e Prizrenit	Strategjia e turizmit ne Komunën e Prizrenit	30,000.00
2	Spitali rajonal i Prizrenit	Furnizimi me pajisje mjekësore, inkubator, shtretër dhe pajisje për transfuzion	80,000.00
3	KEKU	Furnizim me licencë për AutoCad dhe Matlab	258,208.17
5	Instituti gjyqësor i Kosovës	Sigurimi fizik i objektit	12,000.00
4	Komuna e Vitisë	Mbikëqyrja profesionale e projekteve kapitale	25,000.00

5	Komuna e Vitisë	Mbikëqyrja profesionale e projekteve kapitale	25,000.00
6	Komuna e Lipjan	Furnizime me material dhe pajisje te imta për mirëmbajtjen e objekteve te institucioneve komunale-ri tender II	20,000.00
7	Ministria e Arsimit	Furnizim me vetura	150,000.00
8	Universiteti I Prishtinës	Furnizim me pajisje te teknologjisë informative për nevojat e UP-së Hasan Prishtina	200,000.00
9	Komuna e Prishtinës	Furnizim me kamion për mbeturina	200,000.00
10	Ministria e Shëndetësisë	Furnizimi me produkte farmaceutike	140,000.00
11	Ministria e Shëndetësisë	Furnizimi me produkte farmaceutike nga L.E	4,000,000.00
12	Ministria e Shëndetësisë	Furnizim me barna, material medicinal, material stomatogjik dhe pajisje medicinal	140,000.00
13	QKUK	Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike për qendrën diagnostike dhe institucionin e onkologjisë	800,000.00
14	Universiteti i Prizrenit	Renovimi I Fakultetit te Edukimit	800,000.00
15	QKUK	Furnizim me pjese rezerve për pajisje mjekësore	400,000.00
16	Universiteti i Prishtinës	Pastrimi i objekteve të UP	
17	Komuna e Klinës	Shtruarja me kubëza të hapësirave publike- trotuareve ne qytet	5,000.00
18	Institucioni i Avokatit te Popullit	Furnizimi me dy automjete /vetura për nevojat te IAP Lot I	40,000.00
19	Ministria e Shëndetësisë	Furnizimi me cito statikë nga Lista Esenciale	2,000,000.00
20	Komuna e Graçanicës	Furnizim me aparature mjekësore	110,000.00
21	Ministria e Arsimit	Ndërtimi I shkollës fillore ne Mitrovice	2,000,000.00
22	Komuna e Ferizajit	Furnizime me një aparat te mamografise për diagnostikimin e kancerit te gjirit"	35,000.00
23	KOSTT	Furnizimi dhe instalimi I TR3, 40MVA në NS 110/10 kv- Prishtine 2	1,150,000.00
24	Komuna e Prizrenit	Furnizimi me karburante për nevojat e Komunës se Prizrenit	400,000.00
25	Komuna e Deçanit	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve ne territorin e Komunës se Deçanit	1,500,000.00
26	Ministria e zhvillimit ekonomik	Shërbimet këshillëdhënëse për njësinë e implementimit të projektit (njip) " TC Kosova e re"	550,000.00
27	RTK	Blerja e veprave Audiovizuale nga producentet e pavarur për RTK-TV1: RTK TV-2: RADIO KOSOVA- 1 dhe 2	1,500,000.00
28	Ministria e Administratës te Pushtetit Lokal	Përgatitja dhe transmetimi i spotit televiziv-e drejta e qytetarit ne vendimmarrje - përcjellje on-line e mbledhjen te asambleve	5,000.00
Totali:			16,575,208.17 €

Tabela 11. Aktivitetet e ndërprera te prokurimit mbi bazën e opinioneve te AKK-së

Të gjitha opinionet e Agjencisë janë marrë parasysht dhe institucionet kanë vepruar duke i ndaluar procedurat tjera. Shuma e aktiviteteve tenderuese të stopuara është 16, 575, 208.17.

6. Mbështetja profesionale dhe Marrëdhëniet me Publikun

Në kuadër të Zyrës së Drejtorit ekzistojnë njësi të caktuara që kryejnë shërbime administrativo-profesionale si dhe kultivojnë frymën e transparencës duke dhënë mbështetje profesionale për stafin e agjencisë. Këtë mbështetje e ofrojnë këto zyre dhe njësi:

- Zyra për mbështetje profesionale dhe bashkëpunim ndërkombëtar;
- Resurset njerëzore; dhe
- Prokurimi.

6.1 Mbështetja profesionale, Bashkëpunimi dhe Informimi

Aktivitetet e AKK-së që kanë të bëjnë me Zyrën për mbështetje, bashkëpunim dhe Informim udhëhiqen nga shefi i zyrës, zyrtari i lartë ligjor, administratori i sistemit të teknologjisë informative dhe zyrtari i lartë për arkiva. Sa i përket aktiviteteve të saj gjatë periudhës raportuese, Zyra për mbështetje bashkëpunim dhe informim, është përqendruar në këto aktivitete:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Takimet me gazetarë dhe qytetarë;
- Konferencat dhe komunikatat për shtyp;
- Monitorimi i mediave;
- Ndihma Ligjore
- Administrimi i teknologjisë informative
- Arkiva qendrore.

Bashkëpunimi dhe informimi - AKK vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit të mirë me institucione dhe organizata ndërkombëtare. Gjatë vitit 2013, zyrtarët e Agjencisë kanë marr pjesë në disa konferenca vendore dhe ndërkombëtare, nga ku kanë marrë përvoja në luftën kundër Korrupsionit. Student ndërkombëtar, kane shfaqur interesim të vazhdueshëm për AKK-në, ata kanë gjetur gatishmërinë e Drejtorit dhe stafit të Agjencisë për ti njoftuar rreth punës së Agjencisë në përgjithësi.


Takimet me gazetarë dhe qytetarë - Gjatë periudhës raportuese, për iniciativat dhe aktivitetet e AKK-së, ka pasur një interesim të madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve të shoqërisë civile ashtu edhe nga ana e publikut, ku është demonstruar një gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar ngushtësisht në luftën kundër korrupsionit. Zyrtarët e AKK-së kanë qenë gjithmonë të gatshëm që çdo të interesuari ti ofrohet ndihma profesionale si edhe bashkëpunimi në rastet kur ka pasur dyshime të bazuara për raste korruptive.

Konferencat dhe komunikatat për shtyp - AKK gjatë periudhës raportuese, ka luajtur një rol të rëndësishëm në bërjen publike dhe në shpërndarjen e komunikatave për shtyp lidhur me aktivitetet për hetimin e rasteve të dyshuara korruptive por edhe përkitazi me rezultatet e deklarimit të

pasurisë së zyrtareve të lartë, në të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike. Gjatë kësaj periudhe janë bërë publike mbi 210 aktivite si , komunikata, njoftime, opinione, reagime, takime, trajnime, që janë publikuar në web faqen e AKK-së dhe disa prej tyre janë përcjell në media. Një interesim shumë i madh i medias dhe publikut në përgjithësi ka qenë i shprehur me rastin e bërjes publike të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe konfliktit të interesit.

Monitorimi i mediave - Shkrimet e mediave për punën e AKK-së mbledhen dhe këto raportet mediale rregullohen në formë fletushke, ku mediat kanë bërë prezantimin e punës së Agjencisë kundër Korrupsionit gjatë vitit 2013. Po ashtu një angazhim tjetër ka qenë monitorimi i shkrimeve mediale që kanë të bëjnë me raportimet përkitazi me aktivitetet e dyshuara korruptive nga individ në institucionet publike.


Gjatë vitit 2013 janë publikuar në mediat e shkruara dhe elektronike rreth 191 shkrime për dyshime për korrupsion. Tabela e më poshtme pasqyron në formë grafike numrin e shkrimeve për korrupsion të cilat janë publikuar nga mediat e shkruara të Kosovës gjatë vitit 2013.



Grafiku 9. Shkrimet për Korrupsion në shtypin ditor sipas muajve gjatë vitit 2013

Sa i përket punës së AKK-së janë botuar gjithsej 198 artikuj , intervista, komente, dhe opinione të ndryshme për punën e Agjencisë. Në sensin e një vlerësimi në kuptim të pozitivitetit të raporteve për këtë institucion del se mbi 70% të shkrimeve kanë qenë pozitive për punën e AKK-së.

Grafi i më poshtme pasqyron në formë grafike numrin e shkrimeve që janë botuar në mediat e shkruara të Kosovës për punën e AKK-së sipas muajve gjatë vitit 2013.



Grafiku 10. Numri i shkrimeve i të gjitha mediave të shkruara për punën e Agjencisë

Menaxhimi i sistemit të TI-së

Në aspektin e teknologjisë informative (TI), digjitalizimit të të dhënave, në AKK ka pasur ngritje, gjegjësisht është bërë avancim si në aspektin e harduerit, ashtu edhe në atë softuerit.

Gjatë vitit 2013 AKK, ka bërë modifikimin e ueb aplikacionit – SDRP-së, në përputhje me ndryshimet që janë bërë në formularët e deklarimit të pasurisë, sipas ligjit aktual të deklarimit të pasurisë. Me këtë, baza e të dhënave e AKK-së SDRP (Sistemi i Deklarimit dhe Regjistrimit të Pasurisë) është avancuar në aspektin teknik dhe praktik. Madje kemi bërë edhe avancime të tjera në SDRP, posaçërisht në aspektin e nxjerrjes së raporteve analitike për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Po ashtu ngritja e SDRP-së është bërë edhe për departamentin e Hetimeve të AKK-së, me këtë është hapur mundësia e digjitalizimit të të dhënave të këtij departamenti.

Edhe këtë vit kemi vazhduar në mënyrë të njëjtë të bëjmë publikim e deklarimit të pasurisë, duke shfrytëzuar SDRP-në, me këtë rast SDRP në mënyrë automatike bënë përpunimin e të dhënave të futura në te, dhe nxjerr regjistra të veçantë për secilin zyrtar në formatin pdf, të cilët regjistra i publikojmë në ueb faqen e AKK-së: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,1178>.

Për çdo vit sistemi i teknologjisë informative është avancuar dhe ka përcjell teknologjinë së bashku me profesionalizmin .

6.2 Resurset njerëzore

Në vitin 2013 zyra e personelit i ka përmbushur obligimet dhe përgjegjësit e saj të përshkruara sipas rregullores së punës të përcaktuara me ligj.

Njëri ndër objektivat e Zyrës së Personelit për vitin 2013 ka qenë kompletimi i stafit prej 40 zyrtareve, obligim i arritur pas procedurave të rekrutimit të parapara sipas Ligjit për Shërbimin Civil dhe rregullores për Përzgjedhjen dhe Rekrutimin e Shërbyesve Civil të Republikës së Kosovës.

Në vitin 2013, janë zhvilluar njëmbëdhjetë procedura të rekrutimit, për pozitë të mëposhtme, siç

janë:

- 1- Zyrtar i Larte për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin publik janë zhvilluar katër procedura ;
- 2- Menaxher i Prokurimit -janë zhvilluar katër procedura ;
- 3- Zyrtar i Larte për Parandalimin e Konfliktit të Interesit- janë zhvilluar dy procedura, dhe
- 4- Zyrtar i Larte për Mbikëqyrje të Pasurisë dhe Dhuratave- një procedure.

Pas shpalljes së konkurseve në shtypin ditor dhe pas procedurës së rekrutimit kemi rezultuar me pranimin e 8 (tete) zyrtareve të ri.

Komisioni i ankesave i AKK-së përmes Zyrës së Personelit në vitin 2013 ka pranuar 9 (nëntë) ankesa të kandidateve për mospajtimin e zgjedhjes së tyre në listën e ngushtë pas procedurave të rekrutimit. Nga këto nëntë ankesa, në gjashtë prej tyre kemi marrë konfirmimin pozitiv nga KPMSHCK se procedura e rekrutimit është udhëhequr në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Trajnime dhe punëtori: Janë mbajtur trajnime dhe punëtori të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit ku janë përfshi një numër i madh i zyrtarëve të AKK-së. Si aneks ([Shtojca B4](#)) shihni të bashkangjitur evidencën e trajnimeve për këtë periudhë kohore.

7. Administrata dhe financat

Administrata dhe financat e agjencisë menaxhohen nga një divizion i veçantë (Divizioni për punë të përgjithshme dhe financa) që punën e tij e përqendron në kryerjen e shërbimeve administrative, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe financat, përkthimet, depoja, dhe menaxhimin e pasurive të agjencisë.


Aktivitetet kryesore janë:

- Planifikimi dhe hartimi i buxhetit
- Realizimi i shpenzimeve

7.1 Planifikimi dhe hartimi i buxhetit

Në bashkëpunim me zyrën e Drejtorit, dhe departamentet tjera është bërë vlerësimi i kërkesave dhe i nevojave financiare për vitin 2013. Në bazë të këtij vlerësimi i është bërë kërkesë Kuvendit të Republikës së Kosovës për ndarje buxhetore për AAK-në, për vitin 2013, në shumën prej 483,565.00 €.

Grafi i mëposhtëm pasqyron shpërndarjen buxhetore nëpër kategori të caktuara ekonomike.




Grafiku 11. Shpërndarja buxhetore nëpër kategori të caktuara ekonomike.

Realizimi i shpenzimeve

Gjatë vitit 2013 ekzekutimi i buxhetit ka qenë i nivelit të kënaqshëm. Nga ndarjet e përgjithshme prej 483,565.23 €, AKK ka shpenzuar shumën prej 447,939.23 euro, apo shprehur në përqindje 92.63% në vlerën totale.


Ndërsa përqindja e realizimit të buxhetit për vitin 2013, sipas kategorive ekonomike paraqiten në grafikun në vijim:



Grafiku 12. Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike

Nga të dhënat po vërehet se ndarjet fillestare janë të njëjta me ato finale. AKK gjatë procesit të

rishikimit të buxhetit, nuk ka pasur nevojë për mjete shtesë buxhetore dhe as për transferim të brendshëm në mes kategorive ekonomike. Shpenzimi i parave të imta (petty cash), për vitin 2013 kap vlerën 1,874.96 €. Grafi në vijim pasqyron një krahasim të buxhetit të përgjithshëm dhe realizimi i tij për vitet 2011-2013.



Grafiku 13. Krahasimi i buxhetit të përgjithshëm dhe realizimi i tij për vitet 2011-2013.

8. BASHKËPUNIMI DHE AKTIVITETET TJERA

AKK vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit të mirë me institucione dhe organizata si vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Gjatë vitit 2013, janë bërë vizita studimore, konferenca, vendore e ndërkombëtare, ku zyrtarët e Agjencisë kanë marrë përvoja në luftën kundër Korrupsionit. Disa aktivitete bashkëpunuese janë zhvilluar në mes AKK-së dhe Komisionit Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të Malit të zi, një vizitë studimore është realizuar nga zyrtarët e AKK-së në Podgoricë, ndërsa në nëntor Agjencia ishte nikoqire e një delegacioni të këtij institucioni në Prishtinë. Student vendor dhe ndërkombëtar, kanë shfaqur interesim të vazhdueshëm për AKK-në, ata kanë gjetur gatishmërinë e Drejtorit dhe stafit të Agjencisë për ti njoftuar rreth punës së Agjencisë në përgjithësi. Për më tej në sensin e vetëdijesimit të publikut AKK-ja ka marrë pjesë në tryeza të rumbullakëta të organizuara bashkërisht me organizatat e ndryshme si vendore ashtu edhe ndërkombëtare për të realizuar njërin nga objektivat e AKK-së vetëdijesimin e publikut kundër korrupsionit.

Me ndihmën e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë EULEX Agjencia në fillim të muajt mars lansoj spotin televiziv që si target kishte zyrtarët e lartë publik për informimin e tyre rreth mënyrës së re të deklarimit të pasurisë.

Spoti ishte transmetuar për një muaj rresht (gjatë gjithë procesit të deklarimit të pasurisë) në RTK dhe pati një efekt të madh në vetëdijesimin e këtij “fokus grupi” rreth masave të reja që qenë futur në Kodin Penal të Kosovës. Brenda periudhës raportuese, zyrtarët e AKK-së kanë marrë pjesë në disa

debate (tryeza të rrumbullakëta) në më shumë se 30 debate mediale në mediat elektronike (TV dhe Radio).

Në frymën e kultivimit të bashkëpunimit, AKK gjithashtu ka pasur një bashkëpunim të mirë në zhvillimin e projekteve vetëdijesuese dhe në parandalimin e korrupsionit të cilat janë mbështetur financiarisht nga organizatat ndërkombëtare, si UNDP-ja, Këshilli i Evropës por edhe projekte që janë implementuar nga organizatat e shoqërisë civile. Në këtë drejtim Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara UNDP zyra në Kosovë përmes një konsulenti lokal ka ndihmuar Agjencinë në zhvillimin e disa aktiviteteve që kanë pasur të bëjnë me Marrëdhëniet Publike ose aktivitete tjera koordinuese me shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare. Si rrjedhojë AKK ka qenë bashkë organizatorë me UNDP-në dhe AGPK-në në dhënien e çmimit për gazetari me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Korrupsionit që jepet në shenjë të nxitjes së transparencës në Kosovë dhe mbështetjes së gazetarisë hulumtuese kundër korrupsionit.

Po ashtu në mbështetje të dy organizatave ndërkombëtare të lartë përmendura zyrtarët e Agjencisë kanë marr pjesë në disa konferenca ndërkombëtare ku kanë pasur mundësin të prezantojnë angazhimin e shtetit dhe masat e ndërmarr prej tij në luftën dhe parandalimin e Korrupsionit.

9. MËSIMET DHE REKOMANDIMET

Gjatë realizimit të misionit të saj, Agjencia ka vërejtur se disa gjëra duhet të përmirësohen në të ardhmen, dhe atë në këto drejtime:

- **Forcimi i bashkëpunimit me Prokuroritë;** - Deri më tani prokurorit e vendit nuk e kanë praktikuar që të kërkojnë bashkëpunim me Agjencinë në fazën e hetimeve penale për rastet të cilat i adreson Agjencia. Një gjë e tillë duket e pajustificueshme dhe është më se e nevojshme të ndodhë një gjë e tillë, pasi që këtë praktik janë duke e ndjekur prokurorët ndërkombëtar të EULEX-it;
- **Ngritja e kapaciteteve për rastet që lidhen me prokurimin publik:** - Për luftimin e korrupsionit në rastet që kanë të bëjnë me fushën e prokurimit publik nevojitet të ketë me shume trajnime të përbashkëta sidomos në sferën e ngritjes profesionale për njohurit nga fusha e Prokurimit Publik, pasi që në këtë fushë njohurit e shume prokuroreve ende janë shumë bazike;
- **Hedhja poshtë e kallëzimeve penale;** - Insistimi i vazhdueshëm i prokuroreve që Agjencia të siguron/vërteton qëllimin e një veprë korruptive është jo profesionale. Baza juridike (neni 22 i Kodit Penal) është e mjaftueshme dhe siguron bazë të fuqishme juridike që Prokurorët të jenë më insistues në trajtimin adekuate të kallëzimeve penale që po i ushtron Agjencia;
- **Publikimi i emrave të akuzuarve ose të dënuarve:** - Publikimi i emrave të personave të akuzuar si dhe publikimi i emrave të personave të gjykuar për korrupsion do të ndikonte shume pozitivisht në rritjen e besimit të qytetareve tek sistemi i drejtësisë në tërësi;
- **Seriozitet në deklarimin e pasurisë:** - Deklarimi i Pasurisë duhet të jetë i plotë dhe real,


mos deklarimi i bizneseve, mos deklarimi i të hyrave reale, mos deklarimi i të gjitha vendeve tjera të punës dhe mos deklarimet tjera për të cilat Agjencia po siguron prova në mënyra të ndryshme, ka ndikuar shume që kundër një numri jo të vogël të zyrtareve të ushtrohen kallëzime penale për Deklarim të rrejshëm të pasurisë;

- **Krijimi i regjistrave për pranimin e dhuratave:** - Evidenca e pranimit të dhuratave po neglizhohet nga shume institucione, Përveç zyrës së Presidentes e cila është model se si duhet të evidentohen, si duhet ruajtur dhe si duhet të raportohet për pranimin e tyre, asnjëri nga institucionet tjera nuk e kanë të rregulluar këtë çështje. Prandaj është e nevojshme që të gjitha institucionet të krijojnë në mënyrën më profesionale regjistrat dhe katalogët e dhuratave;
- **Vetëdijesimi për Konfliktin e Interesit:** - Shume zyrtare po i neglizhojnë kërkesat e Agjencisë për ti ndërmarrë veprimet për të parandaluar Konfliktin e Interesit. Faktikisht rasti i hapur nga Agjencia në asnjë mënyrë nuk do të mbyllet pa e marrë epilogun zyrtarë. Rekomandohet që zyrtarët të cilët janë pjesë e procedurave shqyrtuese për ekzistimin e mundshëm të Konfliktit të interesit të tregojnë gatishmëri më të madhe për bashkëpunim dhe të reflektojnë në bazë të vendimeve të Agjencisë;
- **Opinionet dhe veprimet e institucioneve:** - Institucionet të cilat zhvillojnë aktivitete të prokurimit dhe në të cilat AKK merr pjesë si monitoruese duhet ta kuptojnë se përshkrimi i Opinionit nuk është çështje që negociohet. Vendimet janë publike dhe mund të ndryshohen vetëm nëse paraprakisht Institucionet veprojnë sipas opinionit të Agjencisë.

10. Përfundimi

Megjithëse e ekspozuar para disa presioneve ose tendencës së ndikimit në punën e saj, megjithatë Agjencia mbetet e përkushtuar në realizimin e misionit të vetë i përcaktuar me kornizën ligjore. Agjencia mbetet rrënjësisht e vendosur në zbatimin me përpikëri të ligjeve që ia përcaktojnë misionin e saj, dhe do të vazhdojë të jetë e palëkundur kundrejt çdo lloji presioni të çfarëdo lloji adrese. Agjencia inkurajon të gjithë zyrtarët e lartë që në bashkëpunim me Agjencinë të jenë korrekte dhe ti kenë në konsideratë parimet që janë udhërrëfyes për punën e saj.

Shtojca A. Organogrami i Agjencisë



Shtojca B. Tabelat

Shtojca B1. Pasqyron raportimin në lidhje me zbatimin e veprimeve kundër korrupsionit nga pikat e kontaktit për periudhën qershor – dhjetor 2013.

Nr.	Institucioni	Veprimet e planifikuara	Veprimet e realizuara	Veprimet pjesërisht të realizuara	Veprimet e paralizuar	Veprimet e paraportuara
1.	Zyra për Qeverisje të Mirë	14	1	3	3	7
2.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	10	4	3	1	2
3.	Këshilli Prokurorial i Kosovës	7	4	2		1
4.	Agjencia Kosovare e Privatizimit	3	1	1		1
5.	Kuvendi i Kosovës	5			4	1
6.	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	3	3			
7.	Agjencia kundër Korrupsionit	8	7		1	
8.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	8	3		3	2
9.	Ministria e Administratës Publike	9	5	2	2	
10.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	3	3			
11.	Administrata Tatimore e Kosovës	7	5			2
12.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Tokologjisë	6	1	2	1	2
13.	Ministria e Shëndetësisë	5	3	1	1	
14.	Policia e Kosovës	10	6	1		3
15.	Ministria e Drejtësisë	11	6	2	1	2
16.	Inspektorati i Kosovës	2	1			1
17.	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	3	2			1
18.	Dogant e Kosovës	1	1			
19.	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	8	6			2
20.	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik	3		1	2	
21.	Ministria e Financave	1			1	
22.	Këshilli i Pavaur Mbykqyrës i Kosovës	1	1			
23.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	8	3		4	1
24.	Komisioni i Pavarur i Mediave	1			1	
25.	Asociacioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës	2				2
26.	Oda Ekonomike	5				5
27.	Instituti I Kosoves për Administrat Publike	1				1
28.	Shoqëria Civile	10				10
	Organizata “FOL”					
	Organizata “KDI”					
	Gjithsej	155	66	18	25	46

Shtojca B2. Lista e zyrtarëve të lartë publik që nuk e kanë deklaruar pasurinë

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Institucioni	Lloji i deklarimit
1	Berat Buzhala	Kuvendi i Republikës së Kosovës	DRV
2	Shafi Gashi	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	DRV
3	Avni Ahmeti	Agjencia Kadastrale e Kosovës	DRV
4	Vedat Sogonjeva	Ministria e Punëve të Brendshme	DRV
5	Hasan Gigolli	Policia e Kosovës	DRV
6	Osman Sejfia	Ministria e Shëndetësisë	DRV
7	Zika Jkanovic	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	DRV
8	Astrit Haraqija	Komuna e Gjakovës	DRV
9	Saranda Hyseni	Komuna e Gjakovës	DRV
10	Teuta Shala	Komuna e Gjakovës	DRV
11	Violeta Dema	Komuna e Gjakovës	DRV
12	Zymer Berisha	Komuna e Gjakovës	DRV
13	Jehona Hyseni	Komuna Gjilan	DRV
14	Elez Muja	Komuna Gjilan	DRV
15	Stojanovic Milan	Komuna Gjilan	DRV
16	Nerimane Lika	Komuna Kaçanik	DRV
17	Sherife Troni	Komuna Kaçanik	DRV
18	Adem Berisha	Komuna e Malishevës	DRV
19	Raimonda Krasniqi	Komuna e Malishevës	DRV
20	Fatos Kryeziu	Komuna e Malishevës	DRV
21	Milivoje Zhivkovic	Komuna e Novobërdës	DRV
22	Imer Hajdini	Komuna Podujevë	DRV
23	Kadri Osaj	Komuna Skenderaj	DRV
24	Kabil Hajdari	Komuna Viti	DRV
25	Avni Misini	Komuna Viti	DRV
26	Taip Alidema	Komuna Viti	DRV
27	Ahmet Arifi	Komuna Viti	DRV
28	Sabit Zeka	KRU Bifurkacioni	DRV

29	Kemajl Hashani	KRM “Pastrimi”, Sh.a Prishtinë	DRV
30	Ismet Jashanica	Komuna e Lipjanit	DMD
31	Shaban Shala	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	DPLF
32	Zymer Gecaj	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	DPLF
33	Memin Sylaj	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	DPLF
34	Rexhep Kelani	Agjencia Kosovare e Pronës	DPLF
35	Nemanja Radunovic	Zyra Administrative Mitrovica Veriore	DPLF

Shtojca B3. Lista me katalogët dhe regjistrin e dhuratave sipas institucioneve që mbajnë dhe kanë dorëzuar kopjet e katalogut në AKK

Institucionet	Raportimi i pranimit	E mbajnë katalogun	Llojet e dhuratave		
			Protokollare	Të rastit	Gjithsej
Presidenca e Republikës së Kosovës	+	+	8	0	8
Kuvendi i Republikës së Kosovës	-	+	-	-	-
Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës	-	+	-	-	-
Ministria e Financave	-	+	-	-	-
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	-	+	-	-	-
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	-	+	-	-	-
Ministria e Diasporës	-	+	-	-	-
Ministria e Integritetit Evropian	+	+	0	6	6
Ministria për Komunitete dhe Kthim	-	-	-	-	-
Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale	-	-	-	-	-
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës	-	-	-	-	-
Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	-	-	-	-	-
Universiteti i Prizrenit	+		10	0	10
Ministria për Infrastrukturë	-	-	-	-	-
Ministria e Punëve të Jashtme	-	-	-	-	-
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	-	-	-	-	-
Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport	-	-	-	-	-
Ministria e Punëve të Brendshme	-	-	-	-	-
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	-	-	-	-	-
Ministria e Shëndetësisë	-	-	-	-	-
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	-	-	-	-	-
Ministria e Administratës Publike	-	-	-	-	-
Ministria e Drejtësisë	-	-	-	-	-
Agjencia Kundër Korrupsionit	-	+	-	-	-
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	-	+	-	-	-
Institucioni i Avokatit të Popullit	-	+	-	-	-
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	-	-	-	-	-

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	-	-	-	-	-
Prokuroria e Shtetit	-	-	-	-	-
Organi Shqyrtues i Prokurimit	-	-	-	-	-
Komisioni i Pavarur i Mediave	-	-	-	-	-
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	-	-	-	-	-
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës	-	-	-	-	-
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,	-	-	-	-	-
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	-	+	-	-	-
Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	-	+	-	-	-
Agjencia Kosovare e Privatizimit	-	+	-	-	-
Instituti Gjyqësor i Kosovës	-	+	-	-	-
Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina	-	-	-	-	-
Zyra e Rregullatorit për Energji	-	-	-	-	-
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	-	-	-	-	-
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	-	-	-	-	-
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	-	-	-	-	-
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës	+	+	0	13	13
Banka Qendrore e Kosovës	-	+	-	-	-
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	-	+	-	-	-
Agjencia Kosovare e Pronës	-	+	-	-	-
Autoriteti i Aviacionit Civil	-	-	-	-	-
Agjencia Qendrore e Prokurimit	-	-	-	-	-
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	-	-	-	-	-
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	-	Nuk kanë pranuar ti kontrollojnë	-	-	-
Komuna e Graçanicës	+	S'është kontrolluar	3	0	3
Komuna e Prishtinës	+	S'është kontrolluar	4	0	4
Prokuroria Themelore Pejë	+	S'është kontrolluar	0	1	1
Kompania Rajonale e Mbeturinave Çabrat	+	S'është kontrolluar	1	0	1
Gjithsej	-	-	26	20	46

Shtojca B4. Lista e trajnimeve 2013

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Numri i zyrtarëve
1	Certified facilitative financial crime instructor	Instituti i Kosovës kundër krimeve ekonomike	Prishtinë, Kosovë	06 shkurt 2013	1
2	Teknika e Hetimeve Financiare	Policia e Kosovës	Prishtinë, Kosovë	04-07shkurt 2013	2
3	Fraud and Corruption Investigation in Public Procurement	The World Bank Country Office in Kosovo	Prishtinë, Kosovë	25-27 shkurt 2013	15

4	Prokurimi i Centralizuar	Banka Botërore	Prishtinë, Kosovë	4 – 6 mars 2013	4
5	Trajnimi i Etikes për Zyrtaret Publik	Shkolla Regjionale per Administrate Publike (ReSPA)	Danilovgrad, Mali i Zi	12-14 mars 2013	1
6	Seminar rreth Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, Parandalimi i pastrimit të Parave, Financimi i Terrorizmit dhe Konfiskimi i Asetve	Policia e Kosovës	Prishtinë, Kosovë	22 mars 2013	1
7	Financimi i Terrorizmit dhe Konfiskimi i Aseteve	Policia e Kosovës	Prishtinë, Kosovë	27 mars 2013	1
8	Financimi i Terrorizmit dhe Konfiskimi i Aseteve	Policia e Kosovës	Prishtinë, Kosovë	4 prill 2013,	1
9	Political Academy for Progressive Yuth-Kosovo	Friedrich Ebert Stiftung	Prishtinë, Kosovë	04/2013	1
10	Hartimi i Legjislacionit	IKAP	Prishtinë, Kosovë	13 maj 2013	1
11	Çështjet e protokollit Shtetëror	IKAP	Prishtinë, Kosovë	15 maj 2013,	2
12	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Ministria e Financave	Prishtinë, Kosovë	21-23 maj 2013	2
13	Etika dhe Anti- korrupsioni në Administratën Publike	Ministria e Administratës Publike- IKAP	Prishtinë, Kosovë	23-24 maj 2013	1
14	Sjellje Organizative	Instituti i Kosovës per Administrate Publike	Prishtinë, Kosovë	27-28 maj 2013	2
15	Prevention of Corruption: Implementation of Integrity Plans		Podgoricë, Mali i Zi	04-07 qershor 2013	1
16	1.Hyrje në instrumentin e para anëtarësimit (IPA) për Kosovën (moduli parë) 2.Menaxhimi i ciklit të projekteve për IPA(moduli dytë) 3.Përgatitja e termave të referencës(moduli tretë)	IKAP	Prishtinë, Kosovë	10,11 qershor 2013 (moduli parë) 17,18 qershor 2013 (moduli dytë) 24,25 qershor 2013 (moduli tretë)	1
17	Përmirësimi i cilësisë së hetimeve për korrupsion – financiar, ndërinstitutional dhe ndërkombëtar	IGJK	Prishtinë, Kosovë	01-03 korrik 2013	2
18	Përmirësimi i cilësisë së hetimeve për korrupsion – financiar, ndërinstitutional dhe ndërkombëtar	British Embassy & IGJK	Prishtinë, Kosovë	08-10 korrik 2013	3
19	Training workshop Transparent and accountable governance: From Extractive Industries to Budget analysis	Kosovo Foundation for Open Society	Durrës, Shqipëri	10-14 korrik 2013	1

20	Advanced Financial Investigative techniques	Instituti i Kosovës kundër krimeve ekonomike	Prishtinë, Kosovë	13 shtator 2013	1
21	Menaxhimi i Integritetit dhe Planifikimi i Integritetit – Trajnim për Trajnerë	ReSPA	Danilovgrad, Mali i Zi	29 shtator-03 tetor 2013	2
22	Përcjell paranë, Rajoni i Mitrovicës	UNDP	Prishtinë, Kosovë	17-18 tetor 2013	3
23	Balkan Forum for the Promotion of Public Private Partnerships as an anti corruption instrument	C.R.E.A.M	Sofje, Bullgari	02 – 04 nëntor 2013	1
24	Asistenca teknike per përmirësimin e menaxhimit te burimeve njerezore ne shërbimin civil	MAP	Prishtinë, Kosovë	14 nëntor 2013	1
25	Moduli i aprovimeve dhe blerjeve	MF	Prishtinë, Kosovë	19 nëntor 2013	1
26	“Përcjell paranë”, rajoni i Mitrovicës	DHKEK Akademia Policore	Vushtrri, Kosovë	22 nëntor 2013	1
27	Punetoria „Percjellja e parase”	Instituti i Kosovës Kundër Krimeve Ekonomike	Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare – Perëndimi në Gjakovë	06 dhjetor 2013	1
28	Trajnimi i Avancuar mbi Luftën Kundër Korrupsionit	Akademia për Siguri Publike	Vushtrri, Kosovë	09 - 13 dhjetor 2013	1

Agjencia kundër Korrupsionit

Telefoni: 0800 10-800; *email:* info@akk-ks.org; *web:* www.akk-ks.org

Adresa: Rruga Nazim Gafurri, Nr. 31, Prishtinë 10000 Kosovë